



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

15

vite

të Zyrës Kombëtare të Auditimit

RAPORTI VJETOR I PERFORMANCËS
GODIŠNJI IZVEŠTAJ PERFORMANSE
ANNUAL PERFORMANCE REPORT

2018

Prishtinë, Prill 2019



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

15
vite
të Zyrës Kombëtare të Auditimit

RAPORTI VJETOR I PERFORMANCËS

2018

Prishtinë, Prill 2019

Tabela e përmbajtjes

Fjala e Auditorit të Përgjithshëm	3
Fjalori i shprehjeve.....	4
Vizioni, Misioni dhe Vlerat	5
Përmbledhje e fakteve kryesore për vitin 2018.....	6
1 Performanca e Zyrës Kombëtare të Auditimit	10
1.1 Pavarësia dhe Korniza ligjore	10
1.1.1 Pavarësia institucionale	10
1.1.2 Mandati	11
1.2 Qeverisja e brendshme dhe etika.....	11
1.2.1 Planifikimi strategjik dhe operativ.....	11
1.2.2 Mjedisi i kontrollit organizativ.....	13
1.2.3 Komunikimi i brendshëm.....	14
1.3 Mbulimi i auditimit dhe raportimi	14
1.3.1 Fushë veprimi i ZKA-së - llojet e auditimit	15
1.3.2 Auditimet e planifikuara dhe të realizuara	16
1.3.3 Rezultatet e auditimit dhe adresimi i rekomandimeve.....	18
1.3.4 Kontrolli i cilësisë	22
1.4 Menaxhimi Financiar, Pasuritë dhe Shërbimet Mbështetëse	23
1.4.1 Menaxhimi financiar i ZKA-së	23
1.4.2 Shërbimet Mbështetëse	26
1.5 Menaxhimi i burimeve njerëzore.....	27
1.5.1 Burimet njerëzore.....	27
1.5.2 Zhvillimi profesional dhe trajnimi i personelit	28
1.6 Komunikimi dhe Bashkëpunimi me Palët e Interesit	29
1.6.1 Komunikimi me Legjislativin, Ekzekutivin dhe Gjyqësorin	30
1.6.2 Komunikimi me Mediat, Qytetarët dhe Organizatat e Shoqërisë Civile	31
1.6.3 Bashkëpunimi me ISA-të partnere dhe donatorët	32
1.6.4 Konferenca tematike dhe shënimi i 15-të vjetorit të ZKA-së	34
2 Fokusi i aktiviteteve gjatë vitit 2019.....	37
3 Llogaridhënia e ZKA-së.....	38
Shtojca 1: Portofoli i auditimeve për sezonin 2017/18 dhe 2018/19.....	40
Shtojca 2: Pasqyrat financiare dhe raporti i pavarur i auditorit	43
Shtojca 3: Adresimi i rekomandimeve të auditimit për vitin 2017	63

Fjala e Auditorit të Përgjithshëm



Të nderuar deputetë,

Kam kënaqësinë të prezantoj Raportin Vjetor të Performancës së Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA) për vitin 2018, i cili vë në pah të arriturat dhe sfidat tona gjatë këtij viti. Puna jonë është mbështetur në burimet njerëzore dhe financiare të miratuara nga Kuvendi dhe është bazuar në Planin Vjetor të Punës i cili paraprakisht i është dorëzuar Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Ky vit është karakterizuar me vëmendjen tonë në tri drejtime kryesore, ku me një përfshirje të gjerë diskutimi kemi miratuar Planin Strategjik 2018 – 2021 dhe Planin Vjetor Operativ, kemi rritur portofolin e auditimeve të ndërmarrjeve publike dhe të auditimeve të performancës duke mbajtur në plan njëkohësisht të gjitha auditimet financiare. Për më tepër, për herë të parë, ne morëm besimin për auditimin e projekteve të përkrahura nga Banka Botërore dhe disa donatorë tjerë nga vendet e Bashkimit Evropian.

Portofoli i auditorëve të certifikuar është përmirësuar ndjeshëm dhe një sërë trajnimesh në fushën e auditimit janë realizuar me sukses, përfshirë ngritjen e kapaciteteve për zbulimin e mashtrimit.

Ky vit është karakterizuar me rishikimin e plotë të procedurave për adaptimin e praktikave të mira evropiane. Janë bërë të gjitha përgatitjet për dhënien e opinionit të pajtueshmërisë me kornizën rregullative dhe procesi është në fazën e pilotimit. Jam i lumtur që ndikimi ynë në menaxhimin e shëndoshë financiar dhe në arritjen e vlerës për para është rritur. Me gjetjet e rekomandimet dhe pastaj me zbatimin e tyre kemi ruajtur parandë publike dhe kemi ndikuar që disa punë e shërbime të pakryera e të paguara të kryhen plotësisht.

Në këtë vit jubilar, kemi shënuar 15 vjetorin e themelimit të institucionit të Auditorit të Përgjithshëm, me një sërë aktiviteteve profesionale dhe me pjesëmarrje të gjerë ndërkombëtare, sikurse kemi dizajnuar dhe miratuar logon e institucionit. Përgjatë vitit, kemi thelluar bashkëpunimin me institucionet supreme të auditimit të vendeve tjera dhe kjo ka çuar drejt afirmimit të ZKA-së në ngjarje të rëndësishme ndërkombëtare. Po ashtu ishim pjesë aktive në Grupin Punues për Auditimet e Mjedisit të EUROSAT-it, si dhe kemi rritur bashkëpunimet bilaterale në fusha të caktuara me qëllim të shkëmbimit të praktikave të mira dhe përvijës në auditim.

Zyra Kombëtare e Auditimit ka po ashtu sfidat e saj. Me rritjen e ndikimit përmes punës sonë, në raste të izoluar është shfaqur mungesë gatishmërie për bashkëpunim në procesin e auditimit. Po ashtu, në disa raste nuk kemi mundur të marrim në auditim tema të rëndësishme për publikun, sepse burimet tona njerëzore e institucionale janë të pamjaftueshme për të mbuluar të gjitha nevojat dhe ne duhet të sigurohemi që raportet tona të ofrojnë saktësi, cilësi dhe siguri.

Në fund, por si shumë të rëndësishme, dua të nënvizoj përkrahjen e deputetëve në Komisionin për Mbikëqyrje të Financave Publike për trajtimin e raporteve tona.

Prishtinë, 30 prill 2019

Besnik Osmani, Auditor i Përgjithshëm

Fjalori i shprehjeve


AP	Auditori i Përgjithshëm
BE	Bashkimi Evropian
BK	Buxheti i Kosovës
EUROSAI	Organizata Evropiane e Institucioneve Supreme të Auditimit
INTOSAI (ONISA)	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
ISA	Institucioni Suprem i Auditimit
KMFP	Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
OB	Organizata Buxhetore
PFV	Pasqyrat Financiare Vjetore
RVP	Raporti Vjetor i Performancës
RVA	Raporti Vjetor i Auditimit
RFV/BK	Raporti Financiar Vjetor i Buxhetit të Kosovës
SNA	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
SNISA	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
TI	Teknologjia Informative
ZKA	Zyra Kombëtare e Auditimit

Vizioni, Misioni dhe Vlerat

Vizioni

Institucion i besueshëm i auditimit, që përmirëson qeverisjen në sektorin publik, në interes të qytetarëve

Vlerat e Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA)



Misioni

Përmes auditimeve cilësore fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare

Përmbledhje e fakteve kryesore për vitin 2018

Çështjet kryesore (nga Raporti Vjetor i Auditimit 2017)

Në Raportin Vjetor të Auditimit 2017 është kërkuar vëmendja e Kuvendit dhe krerëve të institucioneve publike, për adresimin e çështjeve që kanë të bëjnë posaçërisht me:

- *llogaritë e arkëtueshme*
- *detyrimet e papaguara dhe detyrimet kontigjente, si dhe*
- *regjistrimin, prezantimin dhe trajtimin e pasurive*




Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Ndikimi i punës së ZKA-së


- ✓ Përmirësimi i raportimit financiar dhe zvogëlimi i keq klasifikimeve në planifikim dhe ekzekutim të buxhetit
- ✓ Zvogëlimi i transaksioneve financiare të parregullta
- ✓ Përmirësimi i gabimeve si rezultat i auditimit (kthimi i pagesave në buxhet)
- ✓ Rritja e transparencës për shpenzimin e parasë publike (të gjitha raportet e auditimit janë publikuar)

- ✓ Numri i auditimeve të rregullsisë është rritur për 20%, në krahasim me sezonin 2015/16
- ✓ Janë trefishuar auditimet e performancës, në krahasim me vitin 2016
- ✓ Auditimi i Ndërmarrjeve publike (NP) ka filluar në sezonin auditues 2016/17 me 4 NP. Numri i auditimeve të NP-ve është trefishuar në sezonin auditues 2018/19

Grafiku 1. Portofoli i auditimeve




Grafiku 2. Auditimi i NP-ve



- ✓ Për vitin fiskal 2017 janë dhënë mbi 1,000 rekomandime të auditimit
- ✓ Institucionet e pavarura prijnë për nga numri i rekomandimeve të zbatuara, megjithatë progresi i përgjithshëm nuk është ende i kënaqshëm


Grafiku 3. Rekomandimet e auditimit të rregullsisë për v.fiskal 2017

Rekomandimet e dhëna, sipas institucioneve



Grafiku 4. Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shkalla e zbatimit të rekomandimeve



Përmbledhje e pasqyrave financiare të ZKA-së, për vitin fiskal 2018

- ✓ Shpenzimet për Paga e Meditje dhe Mallra e Shërbime, mbesin shpenzimet kryesore të ZKA. Rritja e personelit auditues dhe vendosja në objektin e ri, janë arsyt e rritjes graduale të shpenzimeve në këto kategori

Grafiku 5. Shpenzimet e ZKA-së për vitin fiskal 2018

Shpenzimet sipas kategorive ekonomike




Tabela 1. Përmbledhje e pasqyrave financiare të ZKA-së (€ 000)

	2018	2017	2016
Burimet e fondeve			
Granti qev eritar	2,678	2,273	2,194
Grantet e përcaktuara të donatorëve	18,9	54	41
Totali i pranimeve	2,697	2,327	2,235
Shfrytëzimi i fondeve			
<i>Operacionet</i>			
Paga dhe Meditje	2,003	1,757	1,690
Mallra dhe Shërbime	613	530	507
Shërbime komunale	30	28	25
	2,646	2,315	2,222
<i>Kapitalet</i>			
Shpenzime kapitale	51	12	13
Totali i pagesave	2,697	2,327	2,235

1. PERFORMANCA E ZYRËS KOMBËTARE TË AUDITIMIT

1 Performanca e Zyrës Kombëtare të Auditimit

Raporti i performancës së aktiviteteve të Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA), për vitin 2018, bazohet në strukturën e **Kornizës së Matjes së Performancës së ISA-ve**, për të demonstruar nivelin e performancës së ZKA-së kundrejt Standardeve Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Korniza e Matjes së Performancës së ISA-ve, si dokument standard i INTOSA-it, ka 25 tregues për të matur performancën e ISA-ve kundrejt praktikave më të mira ndërkombëtare. Këta tregues janë grupuar në gjashtë fusha: 1. Pavarësia dhe Korniza Ligjore; 2. Qeverisja e Brendshme dhe Etika; 3. Mbulimi i Auditimit dhe Raportimi; 4. Menaxhimi Financiar, Pasuritë dhe Shërbimet Mbështetëse; 5. Burimet Njerëzore dhe Trajnimet; dhe 6. Komunikimi dhe Bashkëpunimi me Palët e Interesit.

Së këndejmi, Raporti përfshinë shënime të rëndësishme në lidhje me performancën e institucionit të Auditorit të Përgjithshëm në përmbushjen e obligimeve të tij kushtetuese e ligjore, në pajtim me SNISA.

1.1 Pavarësia dhe Korniza ligjore

Kjo fushë mbulon **mandatin ligjor** dhe **pavarësinë** e institucionit të Auditorit të Përgjithshëm (AP)¹. Përveç kornizës ligjore të vendit, Kushtetutës dhe ligjeve relevante, bazë e praktikave të mira ndërkombëtare për këtë fushë janë Deklarata e Limës (SNISA 1) dhe Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e ISA-ve (SNISA 10). Treguesit që ZKA-ja ka aplikuar për këtë fushë janë: *pavarësia dhe mandati*.

1.1.1 Pavarësia institucionale

Kushtetuta e Republikës së Kosovës e ka cilësuar Auditorin e Përgjithshëm si institucion i pavarur dhe më i larti, i kontrollit ekonomik e financiar në vend. Kompetencat themelore të AP janë përcaktuar me Kushtetutë dhe janë definuar më tej me ligjin e veçantë nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit, i cili ka hyrë në fuqi në qershor të vitit 2016. Sipas legjislacionit në fuqi, AP ka liri të plotë veprimi në kryerjen dhe ushtrimin e funksioneve dhe kompetencave për të zbatuar mandatin e tij. Ai është i pavarur në organizimin dhe menaxhimin e ZKA-së.

Gjatë vitit 2018, nuk janë shënuar raste të ndonjë ndërhyrjeje nga palët e treta në punën e AP. Megjithatë, me Ligjin për Zyratë Publike, të miratuar nga Kuvendi i Kosovës me 02.02.2019, ndërmjet tjerash, ndryshohet edhe statusi juridik i marrëdhënies së punës së auditorëve, respektivisht i stafit auditues të punësuar në ZKA. Si rrjedhim, ky Ligj parasheh që auditorët të kenë rregullim juridik të marrëdhënies së punës si nëpunës civilë - pjesë e Shërbimit Civil të Kosovës. Ky zhvillim është në kundërshtim me proceset integruese evropiane të Kosovës sipas agjendës së Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA) (neni 97) dhe është hap mbrapa në të arriturat e deritanishme në fushën e kontrollit financiar - detyrime që Republika e Kosovës i ka ndërmarrë deri tani.

¹ Në këtë Raport, institucionit të Auditorit të Përgjithshëm do t'i referohemi edhe si Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA).

Ligji për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit përcakton se legjislacioni për Shërbimin Civil nuk zbatohet për AP, Zëvendës AP, Ndihmës AP dhe auditorët e ZKA, ndërsa stafi tjetër trajtohet në bazë të Ligjit për Shërbimin Civil. Në kundërshtim me këtë rregullim që është promovuar nga Bashkimi Evropian në Raportin e Progresit për Kosovën (2012) dhe MSA, me Ligjin për Zyrtarët Publikë, ZKA kthehet në situatë para hyrjes në fuqi të ligjit aktual për AP (qershor 2016). Kjo dëmton statusin e ZKA si një institucion i pavarur i auditimit dhe mund të ketë pasoja të rënda praktike për pavarësinë organizative dhe funksionimin e institucionit dhe në proceset integruese. Për efektet potenciale negative të këtij ligji, AP i ka njoftuar paraprakisht deputetët e Kuvendit dhe aktorët tjerë relevant.

1.1.2 Mandati

Ky tregues vlerëson autoritetin operacional të ZKA-së të përcaktuar në kornizën ligjore. Dimensionet për të vlerësuar këtë tregues janë: Mandati i mjaftueshëm dhe i gjerë; Qasja në informata; dhe E drejta dhe detyrimi për të raportuar.

Kushtetuta e vendit dhe Ligji i veçantë, i japin AP **mandat të gjerë të auditimit** të të gjitha subjekteve të sektorit publik në Kosovë. Megjithatë, disa ligje të veçanta kanë krijuar paqartësi për auditimin e disa subjekteve që çështjen e auditimit e kanë trajtuar në mënyrë tjetër krahasuar me dispozitat kushtetuese dhe ato të Ligjit për AP². Për më tepër Ligji për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim nuk është harmonizuar me Kushtetutën, Ligjin për AP dhe Ligjin për Ndërmarrjet publike, lidhur me mandatin e auditimit të AP dhe afatet kohore për raportim financiar.

AP, sipas autoritetit kushtetues e ligjor, ka **qasje të pakufizuar** në të gjitha informatat dhe shpjegimet, që vlerëson se i nevojiten për qëllime të auditimit. Gjatë periudhës raportuese, bashkëpunimi me subjektet e audituara ka qenë korrekt dhe nuk është shënuar ndonjë rast i kufizimit të qasjes për auditorët. Zyrtarëve të autorizuar nga AP u është mundësuar që në çdo kohë të arsyeshme të hyjnë dhe të qëndrojnë në objektet e entiteteve të audituara.

AP e ka autoritetin kushtetues që në mënyrë të pavarur të **raportoje gjetjet** e çdo viti në Kuvend, dhe mbi këtë bazë, i ka paraqitur atij: raportet individuale të auditimit të subjekteve publike; *Raportin për zbatimin e Buxhetit të Shtetit* si dhe *Mendimin për Raportin e Qeverisë për shpenzimet e vitit financiar të shkuar; dhe Raportin vjetor për veprimtarinë e ZKA-së.*

Sikur edhe vitet paraprake, të gjitha raportet e auditimit, ZKA i ka bërë publike.

1.2 Qeverisja e brendshme dhe etika

Kjo fushë mbulon **qeverisjen e brendshme** dhe **etikën**. Treguesit që ZKA ka aplikuar janë: Planifikimi strategjik dhe operativ; Mjedisi i kontrollit organizativ; dhe Komunikimi i brendshëm.

1.2.1 Planifikimi strategjik dhe operativ

Planifikimi strategjik

Duke pasur parasysh hyrjen në fuqi të legjislacionit të ri për AP, ndryshimet në menaxhmentin e lartë të institucionit, si dhe trendët në zhvillim për sa i përket fushës së auditimit të jashtëm, ZKA hartoi planin e ri strategjik 2018-2021. Plani paraqet një mënyrë të re, më të avancuar të

² BQK – Banka Qendrore e Kosovës; AKI – Agjencia Kosovare e Inteligjencës, RTK – Radio Televizioni i Kosovës, FKPK – Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës dhe së fundmi edhe Ndërmarrja Trepça.

punës që është më e qartë në qëllimet dhe objektivat strategjike, më e integruar dhe që i ofron mundësinë ZKA-së që t'i përgjigjet pritjeve të palëve vendore dhe atyre ndërkombëtare.

Për përgatitjen e këtij plani, ZKA ka ndërmarrë një sërë aktivitete me palët e brendshme dhe të jashtme. Fillimisht është bërë skanimi i gjendjes ekzistuese, përmes konsultimit me palët e interesit dhe studimit të shumë dokumenteve paraprake, të përgatitura në bashkëpunim me partnerët. Ky angazhim që ka rezultuar me një raport përmbledhës të sfidave dhe boshllëqeve, ka dëshmuar që ZKA ka nevojë të zhvilloj më tej kapacitetet institucionale dhe të aplikoj një qasje të hapur ndaj ndryshimit. Kjo do t'i mundësoj ZKA-së që të qeverisë në mënyrë më efektive dhe t'i përgjigjet pritjeve dhe kërkesave të së ardhmes.

Fotogaleria 1. Takimet konsultative me palët e interesit për prezantimin e Planit strategjik



1. Takimi me Komisionet parlamentare: Komisionin për Buxhet dhe Financa dhe Komisionin për Mbikëqyrje të Financave Publike; 2. Takimi me organizatat e shoqërisë civile dhe shoqatat profesionale; 3. Takimi me donatorët; 4. Takimi me personelin e ZKA-së.

Me Planin strategjik janë përcaktuar tri qëllime kryesore:

1. Të përmbushim misionin kushtetues e ligjor, duke kryer auditime relevante, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA);
2. Të zhvillojmë dhe të forcojmë kapacitetin institucional për të mbështetur auditimin dhe qeverisjen korporative; dhe
3. Të zhvillojmë dhe të mirëmbajmë marrëdhënie të mira me palët e jashtme, duke promovuar auditimin, rritur ndikimin dhe duke u integruar në organizatat globale dhe rajonale të Institucioneve Supreme të Auditimit.

Dokumentet strategjike të ZKA-së janë publike dhe të qasshme për publikun e gjerë.

Plani Operativ Vjetor

Ky plan përfshinë projektet, aktivitetet, afatet, burimet e nevojshme, buxhetin dhe burimet e financimit, rezultatet, rreziqet, etj, të ndërlidhura me zbatimin e Planit strategjik e që përfshijnë periudhën njëvjeçare kalendarike, 1 janar deri më 31 dhjetor.

Plani Vjetor i Auditimit

Në fillim të sezonit auditues, AP ka miratuar Planin Vjetor të Auditimit 2018/19, i cili përmban informatat themelore për objektivat vjetore të ZKA-së, procesin e auditimit dhe llojet e tij, planin vjetor të auditimit dhe organizimin, buxhetin dhe burimet njerëzore. Në hartimin e Planit janë marrë në konsideratë përmbushja e obligimeve kushtetuese e ligjore për auditime të rregullsisë, mbulueshmëria sa më e gjerë me auditime të performancës bazuar në vlerësimin mbi rëndësinë dhe aktualitetin e çështjeve të caktuara dhe adresimi i kërkesave specifike të Kuvendit dhe të palëve të tjera të interesit, si donatorët, etj. Planifikimi i këtyre auditimeve është bërë duke pasur parasysh edhe kapacitetet e burimeve njerëzore dhe financiare që ZKA ka pasur në dispozicion.

1.2.2 Mjedisi i kontrollit organizativ

Në funksion të kërkesave që burojnë nga SNISA-t³, si dhe për të përmbushur pritjet nga ZKA, AP ka bërë përshtatjen e strukturës organizative me qëllim të arritjes së objektivave strategjike të organizatës. Struktura e re është po ashtu në funksion të krijimit të një sistemi të kontrollit të brendshëm që ofron siguri të arsyeshme se operacionet e organizatës menaxhohen në mënyrë efikase dhe ekonomike, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Për të forcuar kontrollin e cilësisë në auditim, në pajtim me SNISA 40, me strukturën e re organizative, ZKA ka fuqizuar edhe më tej funksionin e menaxhimit të cilësisë në auditim.

Kodi i Etikës

Në funksion të afirmimit të vlerave dhe parimeve thelbësore që udhëheqin punën e përditshme të audituesve, si dhe për të ruajtur dhe shtuar besimin tek institucioni, ZKA ka krijuar politika dhe procedura, të cilat kërkojnë që gjithë personeli dhe palët e autorizuara për të kryer punë për ZKA-në, të pajtohen me kërkesat etike duke nënshkruar dhe respektuar *Kodin e Etikës* dhe *Deklaratën e pavarësisë profesionale*. Kodi i Etikës dhe Mirësjelljes i ZKA-së është hartuar në frymën e parimeve që përmban Kodi i Etikës i INTOSAI-t. Po ashtu, në ZKA funksionon edhe **Komisioni për Etikë** me mandat që të përcjellë zbatueshmërinë e Kodit të Etikës. Gjatë vitit 2018, ky Komision nuk ka evidentuar ndonjë rast të shkeljes apo mosrespektimit të Kodit.

Sistemi i kontrollit të brendshëm

Kontrollet e brendshme për aktivitetet jo-audituese në ZKA, zbatohen përmes rregullave dhe procedurave të vendosura për procese të ndryshme si: ndarja e detyrave, delegimi, autorizimi, mbikëqyrja dhe auditimi i brendshëm. Po ashtu, ZKA ka hartuar edhe dokumentin për menaxhimin e rreziqeve. Menaxhimi i rrezikut në ZKA zbatohet duke u bazuar në objektivat e vendosura me dokumentet strategjike të ZKA-së dhe kornizën tjetër të aplikueshme për menaxhimin financiar dhe kontrollin (MFK). Lidhur me këtë ZKA ka të dizajnuar një strukturë të

³ Standardi i Qeverisjes 9100, Kontrolli dhe siguri i cilësisë SNISA 40.

mirë të kontrolleve të brendshme. Të gjitha komponentët e kontrolleve operojnë në mënyrë efektive, duke përfshirë edhe vlerësimin e reziqeve.

Auditori i brendshëm i ZKA-së ka përgatitë raporte mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm në fusha të ndryshme dhe i ka raportuar ato drejtpërdrejtë tek AP. Bazuar në planin vjetor për vitin 2018, fushat e përcaktuara për rishikim nga Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB) kanë qenë: menaxhimi i fondit të parasë së imët, aranzhimet e qeverisjes në ZKA, pagat dhe benefitet e personelit, shërbimet e transportit dhe menaxhimi i veturave zyrtare. Rishikimi është bazuar në vlerësim të performancës dhe pajtueshmërisë me rregullat ligjore dhe kornizën e brendshme që rregullon fushat përkatëse. Gjatë vitit 2018, NJAB i ka dorëzuar AP-së pesë (5) raporte të auditimit.

Komiteti i Auditimit ka kryer aktivitetet e tij me qëllim të ngritjes së llogaridhënies dhe përmirësimit të qeverisjes, menaxhimit të rrezikut të kontrollit të brendshëm si dhe mbështetjes së AP-së në adresimin e përgjegjësive lidhur me zbatimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm.

1.2.3 Komunikimi i brendshëm

ZKA-ja ka ndërtuar një komunikim efektiv të brendshëm me punonjësit, duke i dhënë mundësi secilit prej tyre të shprehet hapur si në drejtimin vertikal ashtu edhe në atë horizontal për çështjet që lidhen me punën e tyre si dhe për ato brenda institucionit. Menaxhmenti i ZKA-së ka mbajtur takime periodike me personelin, sipas nevojave zhvillimore. Vendimet kryesore janë dokumentuar dhe i janë komunikuar stafit. Dokumentet relevante janë të qasshme për të gjitha nivelet organizative dhe informacioni shpërndahet tek i tërë stafi, qoftë përmes kanaleve formale (e-mail) apo duke përdorur rrjetin e brendshëm të komunikimit elektronik (Intranetin) përmes të cilit janë informuar rregullisht punonjësit mbi çështjet kryesore lidhur me organizatën dhe procesin e auditimit.

1.3 Mbulimi i auditimit dhe raportimi

Kjo fushë përfshinë **mbulueshmërinë e auditimit** dhe **raportimin**. ZKA auditon Pasqyrat Financiare Vjetore (PFV) të subjekteve publike për të vlerësuar nëse ato ofrojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë dhe nëse paraja publike është shpenzuar për qëllimet për të cilat është aprovuar. ZKA, po ashtu kryen auditime të performancës për të vlerësuar nëse qytetarëve u ofrohen shërbimet që kanë nevojë, me kosto efektive.

Treguesit e kësaj fushe ndërlidhen kryesisht me: *Fushëveprimin e auditimeve, mbulimin e auditimeve; Raportimin e rezultateve të auditimeve dhe adresimin e rekomandimeve nga subjektet e audituara.*

1.3.1 Fushë veprimi i ZKA-së - llojet e auditimit

Në përputhje me fushëveprimin e saj, ZKA kryen kryesisht këto lloje të auditimeve⁴:

1. Auditime të rregullsisë (financiare dhe të pajtueshmërisë)	o Të organizatave buxhetore (ministrive, institucioneve të pavarura dhe komunave), bazuar në sistemin e parasë së gatshme
	o Të ndërmarrjeve publike, bazuar në sistemin aktual
	o Të projekteve të financuara nga donatorët dhe institucionet financiare ndërkombëtare
2. Auditime të performancës	o Të angazhimeve qeveritare, sistemeve, operacioneve, programeve, aktiviteteve ose organizatave
	o Të projekteve të financuara nga donatorët dhe institucionet financiare ndërkombëtare
3. Auditime të teknologjisë informative (TI)	o Të sistemeve të teknologjisë informative (TI) dhe kontrolleve të ndërlidhura me to

Auditimet e rregullsisë në subjektet individuale kryhen për çdo vit, duke filluar në shtator, ndërsa përfundojnë me raportet e auditimit të cilat publikohen deri në fund të muajit qershor. Cikli i auditimeve të rregullsisë përmbyllet në fund të muajit gusht, kur Raporti Vjetor i Auditimit (RVA) për Raportin Financiar Vjetor të Buxhetit të Kosovës (RFV/BK) dorëzohet në Kuvendin e Kosovës. Fushat, objektivat dhe koha e auditimit dhe e raportimit të **auditimeve të performancës** përcaktohen në planin vjetor të auditimit, duke u bazuar në rëndësinë, rrezikun, kapacitetet ekzistuese si dhe kriteret tjera përkatëse.

Në bazë të marrëveshjes me donatorët apo përfituesit e tyre, ZKA kryen auditime të rregullsisë apo të performancës së projekteve të financuara nga donatorët dhe institucionet financiare ndërkombëtare. Për këto auditime ZKA aplikon një tarifë, ndërsa fondet e inkasuara derdhen në Buxhetin e Kosovës.

⁴ Auditimet e TI-së, ZKA i ka zhvilluar kryesisht në kuadër të auditimeve të performancës. Përgjithësisht ISA-të kryejnë auditimin e TI-së njëkohësisht me auditimin e pasqyrave financiare, rishikimin e kontrolleve të brendshme ose si auditim performance të sistemeve të TI-së ose të aplikimeve të TI-së. Auditimet e TI-së shtrihen në auditimet financiare (për të vlerësuar saktësinë e pasqyrave financiare të subjektit); në auditimet e pajtueshmërisë (vlerësimi i kontrolleve të brendshme); në auditimet e performancës (përfshirë çështjet e sistemeve të informacionit), etj.

1.3.2 Auditimet e planifikuara dhe të realizuara

Deri në fund të vitit 2018, ZKA ka përfunduar dhe publikuar **122 raporte** si në vijim:

109 Raporte të auditimit të rregullsisë

- ✓ Raportin Vjetor të Auditimit për Raportin Financiar Vjetor të Buxhetit të Kosovës të vitit 2017
- ✓ 92 raporte për organizatat buxhetore
- ✓ 9 raporte të auditimit të ndërmarrjeve publike, dhe
- ✓ 7 raporte të auditimit të projekteve (të financuara nga donatorët).

13 raporte të auditimit të performancës

- ✓ 13 raporte të auditimit të performancës (për fusha të ndryshme, prokurim, TI, projekte).

Ndërsa, me planin vjetor për sezonin e auditimit 2018/19 (të azhurnuar), ZKA planifikon të kryejë auditimet si në vijim:

116 Auditime të rregullsisë

- ✓ Auditimin e Raportit Financiar Vjetor të Buxhetit të Kosovës të vitit 2018
- ✓ 94 organizata buxhetore (26 institucione të nivelit qendror, 30 institucione të pavarura dhe 38 të nivelit lokal)
- ✓ 12 ndërmarrje publike, dhe
- ✓ 9 auditime të projekteve (të financuara nga donatorët).

15 Auditime të performancës

- ✓ 13 auditime të performancës (për fusha të ndryshme, prokurim, TI), dhe
- ✓ 2 auditime të projekteve (të financuara nga donatorët).

Për dallim nga sezoni i kaluar, në portofolin e auditimeve të rregullsisë janë shtuar dy organizata të reja buxhetore: Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë dhe Ministria e Zhvillimit Rajonal, si dhe do të kthehet në auditim të ZKA-së, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, e cila tri vitet e fundit ishte audituar nga një kompani private e auditimit⁵. Ndërsa, për auditimin e tetë (8) komunave, ZKA ka angazhuar një kompani private të auditimit, e cila do të përkrahë procesin, megjithatë sigurimi i cilësisë së raporteve dhe dhënia e opinionit të auditimit do të bëhet nga AP. Tabela 2 tregon portofolin e përgjithshëm të auditimeve, përfshirë numrin dhe llojet e auditimeve të paraqitura me një bazë krahasuese për katër (4) sezonet/vitet e fundit të auditimit. Evidenca e raporteve të përfunduara dhe të auditimeve në proces është paraqitur në Shtojcën 1 të këtij Raporti.

⁵ Duke respektuar kërkesën ligjore për shmangie të konfliktit potencial të interesit.

Tabela 2. Portofoli i përgjithshëm i auditimeve gjatë katër sezoneve/viteve të fundit

Llojet e auditimit	Sezoni i auditimit	Sezoni i auditimit	Sezoni i auditimit	Sezoni i auditimit
	2015/16	2016/2017	2017/2018	2018/2019
Auditime të rregullsisë	93	99	109	116
- Buxheti i Kosovës	1	1	1	1
- Institucione qendrore	24	24	24	26
- Institucione të pavarura	30	30	30	30
- Komuna	38	38	38	38
- Ndërmarrje publike	0	4	9	12
- Projekte	0	2	7	9 ⁶
	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019
Auditime të performancës	5	11	13⁷	15⁸
- Performancë dhe prokurim	5	9	10	12
- Teknologji Informative	-	2	3	1
- Projekte	-	-	-	2 ⁹
Gjithsej	98	110	122	131

Siç është prezantuar në Tabelën 2 dhe Grafikon 6, numri i auditimeve të rregullsisë është rritur gradualisht (në masën prej 20% krahasuar me sezonin e auditimit 2015/16). Kjo rritje i atribuohet kryesisht zgjerimit të portofolit të auditimeve të ndërmarrjeve publike dhe rritjes së numrit të organizatave buxhetore. Po ashtu, trendi i auditimeve të performancës në tri vitet e fundit është në rritje (është trefishuar numri i tyre në krahasim me vitin 2016), siç mund të shihet edhe në Grafikon 7, më poshtë.


⁶ Me kërkesë të BB, ZKA do të përfshijë në planin auditues për sezonin 2018/19 dy projekte shtesë.

⁷ Raporte të publikuara.


⁸ Auditime të planifikuara, pas azhurnimit të planin auditues.

⁹ Me kërkesën e donatorëve, ZKA do të përfshijë në planin auditues edhe dy projekte shtesë.

Grafiku 6. Trendi i auditimeve të rregullsisë



Grafiku 7. Trendi i auditimeve të performancës



Raportet për auditimet e rregullsisë do të finalizohen sipas afateve ligjore:

- (i) deri më 30 qershor 2019 të gjitha raportet individuale, ndërsa
- (ii) deri më 31 gusht 2019, Raporti Vjetor i Auditimit të Buxhetit të Kosovës.

Raportet për auditimet e performancës (dhe të projekteve) do të publikohen sipas kalendarit kohor të përcaktuar dhe aprovuar nga Auditori i Përgjithshëm.

1.3.3 Rezultatet e auditimit dhe adresimi i rekomandimeve

Auditimet e rregullsisë

AP i ka prezantuar në seancë plenare gjetjet dhe rekomandimet nga Raporti Vjetor i Auditimit (RVA) për vitin 2017. Me këtë rast, ai ka kërkuar vëmendjen e deputetëve dhe të krerëve të institucioneve publike, për çështjet e ngritura në raport, posaçërisht për: **dobësitë në menaxhimin e llogarive të arkëtueshme, detyrimet e papaguara dhe detyrimet kontigjente si dhe regjistrimin, prezantimin dhe trajtimin jo adekuat të pasurive**. Në RVA janë pasqyruar edhe çështje që ndërlidhen me pajtueshmërinë me kuadrin ligjor, si: dobësitë në prokurim, menaxhimin e projekteve, rekrutimet etj, për të cilat janë dhënë rekomandime konkrete.

Ndonëse nuk janë bërë vlerësime individuale për të kuptuar më saktë ndikimin e rekomandimeve të auditimit për subjektet e audituara, konkludimi i përgjithshëm është se ndikimi i punës së ZKA-së mund të vërehet në fushat në vijim: përmirësimi i raportimit financiar dhe zvogëlimi i keq klasifikimeve në planifikim dhe ekzekutim të buxhetit; zvogëlimi i transaksioneve financiare të parregullta; përmirësimi i gabimeve si rezultat i auditimit (kthimi i pagesave në buxhet); rritja e transparencës për shpenzimin e parasë publike (të gjitha raportet e auditimit janë publikuar), etj.

Një dimension tjetër, atë këshillues, ZKA e ka shfrytëzuar për të kontribuar në qeverisjen e mirë publike duke ofruar rekomandime specifike për subjektet e audituara dhe për vendim-marrësit. AP përmes një rekomandimi specifik lidhur me përmirësimin e qeverisjes, me qëllim të rritjes së besueshmërisë në shpenzimin e fondeve publike, ka kërkuar vëmendje për trajtimin me prioritet nga ana e Qeverisë të Udhëzimit Administrativ 2004/2007 për Udhëtimet Zyrtare, i miratuar nga Ministria e Shërbimeve Publike në vitin 2004. Paqartësitë dhe mungesat e identifikuar në kornizën ligjore, kishin ndikuar në aplikimin jo konsistent të saj nga organizatat

buxhetore (OB). Duke vepruar sipas këtij rekomandimi, Ministria e Financave, ndonëse nuk i ka trajtuar të gjitha çështjet e ngritura nga ZKA, ka nxjerrë vendim të ri për tarifatat e mëditjeve dhe i ka përshtatur ato me rrethanat dhe koston e jetës së vendeve përkatëse.

Në raportet e auditimit të vitit 2017 është raportuar për gjendjen e rekomandimeve të dhëna një vit më parë. Rezultatet nga përcjellja dhe analizimi i progresit në zbatimin e rekomandimeve nga organizatat buxhetore dhe NP-të janë përmbledhur në tabelat e mëposhtme, 3, 4 dhe 5.

Tabela 3. Zbatimi i rekomandimeve të dhëna në raportet e vitit 2017 (për v. 2016), nga OB

Subjektet e audituara	Rekomandimet e dhëna	Të zbatuara		Të adresuara pjesërisht apo në proces		Të pa adresuara	
		Nr	%	Nr	%	Nr	%
Institucionet qendrore	307	112	36	57	19	138	45
Institucionet e pavarura	220	118	54	63	29	39	17
Komunat	650	165	25	191	29	294	45
Totali	1,177	395	34	311	26	471	40

Tabela 4. Zbatimi i rekomandimeve të dhëna në raportet e vitit 2016 (për v. 2015), nga OB

Subjektet e audituara	Rekomandimet e dhëna	Të zbatuara		Të adresuara pjesërisht apo në proces		Të pa zbatuara	
		Nr	%	Nr	%	Nr	%
Institucionet qendrore	338	93	28	126	37	119	35
Institucionet e pavarura	184	52	28	70	38	62	34
Komunat	640	153	24	229	36	258	40
Totali	1,162	298	26	425	36	439	38

Në vitin 2017, ZKA ka dhënë gjithsej 1,177 rekomandime, 15 më shumë se në vitin 2016. Nga auditimi i kryer është konstatuar një përmirësim i nivelit të adresimit të rekomandimeve nga institucionet e pavarura dhe në një shkallë më modeste edhe nga komunat, ndërkaq gjendja tek institucionet qendrore është përkeqësuar për sa i përket rekomandimeve të pa zbatuara. Në përgjithësi shkalla e zbatueshmërisë së rekomandimeve të auditimit është përmirësuar ndjeshëm nga viti 2016 në vitin 2017 (nga 26% në 34%).

Për sa i përket Ndërmarrjeve publike, nga katër (4) NP-të e audituara për vitin fiskal 2016¹⁰, ZKA në vitin vijues ka vazhduar auditimin e dy prej tyre dhe rezultatet nga përcjellja dhe analizimi i progresit në zbatimin e rekomandimeve për këto dy NP është paraqitur në Tabelën 5, më poshtë.

¹⁰ Për vitin fiskal 2016 nga ZKA janë audituar 4 NP: Kompania për menaxhimin e Deponive në Kosovë (KMDK); Hekurudhat e Kosovës – TrainKos; Ngrohitorja e qytetit – Gjakovë; dhe KRM Pastërtia – Ferizaj. Për këto 4 NP janë dhënë gjithsej 67 rekomandime. NP-të: Ngrohitorja e qytetit Gjakovë (15 rekomandime për vitin 2016) dhe KRM Pastërtia Ferizaj (17 rekomandime për vitin 2016), janë audituar nga kompanitë private të auditimit për vitin fiskal 2017 dhe rrjedhimisht ZKA nuk posedon shënime lidhur me progresin e zbatimit të rekomandimeve për vitin 2016.

Tabela 5. Progresi në zbatimin e rekomandimeve nga NP-të e auditurara në vitin fiskal 2016

Ndërmarrja publike e audituar	Rekomandimet e dhëna	Të zbatuara		Të adresuara pjesërisht apo në proces		Të pa zbatuara	
		Nr	%	Nr	%	Nr	%
Hekurudhat e Kosovës - Trainkos	19	7	37	7	37	5	26
Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë (KMDK)	16	6	37.5	8	50	2	12.5
Totali	35	13	37	15	43	7	20

Gjithashtu, ZKA ka vlerësuar zbatimin e rekomandimeve të RVA-së të dhëna për Kuvendin e Kosovës, Qeverinë dhe për kuvendet komunale. Nga gjithsej 47 rekomandime¹¹ të dhëna, tetë (8) janë zbatuar plotësisht, 11 ishin në proces të zbatimit dhe 17 të tjera nuk ishin adresuar ende. Për 11 rekomandimet e dhëna në auditimet e performancës, mbetet të bëhet auditimi përcjellës i zbatimit të tyre, në mënyrë që të bëhet një vlerësim i saktë i progresit. Për rekomandimet e dhëna në RVA për vitin 2017, Qeveria përkatësisht Ministria e Financave ka përgatitur planin e veprimit, ndërsa ZKA do të vlerësoj progresin e tyre në RVA për vitin 2018, i cili do të finalizohet në gusht të vitit 2019.

Auditimet e performancës

Raportet e auditimit të performancës të publikuara gjatë vitit 2018 kanë mbuluar fusha të ndryshme me interes ekonomik, shoqëror në aspektin e mbulimit të çështjeve me rëndësi që lidhen me fushën sociale e ekonomike, mjedisin, shëndetësinë, prokurimin, infrastrukturën, teknologjinë informative. Një raport i veçantë është përgatitur edhe për zbatimin e rekomandimeve të auditimit për fushën e shëndetësisë.

Në vitin 2018, ZKA ka mbuluar mbi 50 subjekte¹² të auditimit, duke rezultuar me 193 gjetje dhe 175 rekomandime. AP lidhur me auditimet e performancës është shprehur dhe ka dhënë mesazhet kryesore për këto raporte që janë shpalosur në vijim.

Menaxhimi i marrëveshjeve të bashkëfinancimit me donatorët dhe rezultatet e arritura. Raporti ka gjetur që Qeveria e Kosovës nuk ka arritur që të jetë efektive në instalimin e mekanizmave të qëndrueshëm të cilët do të ndihmonin në koordinimin, monitorimin dhe raportimin e marrëveshjeve të bashkëfinancimeve me donatorët. Qasja dhe gjurmueshmëria e informatave të qeverisë për marrëveshjet e bashkëfinancimit deri tek përfituesi i fundit është mjaftë e vështirë. Qeveria nuk i ka deleguar përgjegjësitë tek asnjë institucion i cili do të mirëmbante informacionin se sa është vlera financiare e ndihmës së jashtme,

sa është financimi nga institucionet e Kosovës, cili sektorë është financuar si dhe cili është progresi i realizimit të bashkëfinancimeve.

Efektiviteti i sistemit informativ të tatimit në pronë. Ky sistem nuk është plotësisht efektiv në procesimin e të dhënave për tatimin në pronë. Mangësitë në qeverisje dhe aplikimin e teknologjisë informative, janë dy nga shkaqet kryesore. Edhe pse projekti është paraparë të përfundoj në dhjetor të vitit 2017, Ministria e Financave (MF) ende nuk ka arritur të përmbush kushtet e marrëveshjes, duke rrezikuar ndërprerjen e saj. Bartja e

¹¹ Prej këtyre rekomandimeve, 14 janë dhënë për Kuvendin e Kosovës, 24 për Qeverinë, 7 për bordet e drejtorëve, përkatësisht aksionarët e NP-ve dhe 2 për Kuvendet komunale. Nga këto rekomandime, 11 janë dhënë në lidhje me auditimin e performancës.

¹² Ka raste kur një Ministri/komunë ka qenë subjekt i auditimit më shumë se një herë.

tërësisht e përgjegjësive tek MF ende nuk ka filluar ashtu siç është paraparë në fazën e tranzicionit të projektit duke e vënë në pikëpyetje funksionimin dhe qëndrueshmërinë e sistemit.

Menaxhimi dhe shfrytëzueshmëria e aplikacionit e-Pasuria. Aplikacioni softuerik e-Pasuria nuk ka arritur qëllimin e tij kryesor, për të krijuar një bazë qendrore të unifikuar për menaxhimin efektiv të pasurisë publike. Niveli i shfrytëzueshmërisë është i ndryshëm në organizata buxhetore, disa prej tyre e përdorin në mënyrë më efektive këtë aplikacion, por ka prej atyre që nuk e përdorin fare apo kanë përdorim të kufizuar të këtij aplikacioni.

Mekanizmat institucional për rregullimin ligjor, monitorimin dhe raportimin e cilësisë së ajrit. Ndotja e ajrit në Kosovë është shqetësuese për shëndetin e qytetarëve, e akoma më shqetësues është fakti se qytetarët nuk janë të informuar me kohë dhe si duhet për këtë problematikë. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) nuk i ka vendosur të gjitha parakushtet e nevojshme ligjore për rregullimin e gjendjes së cilësisë së ajrit në Kosovë. Gjatë viteve 2016 dhe 2017, parametrat e rrezikshëm për shëndetin e njeriut siç janë grimcat e pluhurit PM10 dhe PM2.5, nuk janë raportuar për muaj të tërë, e sidomos gjatë muajve të dimrit kur këta parametra arrijnë vlera maksimale. Pavarësisht monitorimit dhe raportimit të mangët, në ato raste kur është raportuar, janë regjistruar tejkallime alarmante të parametrat PM10 që kanë arritur deri në 400% tejkallim.

Vlera për para në prokurimet e centralizuara. Agjencia Qendrore e Prokurimit (AQP) nuk kishte arritur të kryej prokurime efikase dhe ekonomike përmes procedurave të centralizuara, të cilat do të rezultojnë me kursime buxhetore. Raporti tregon se në shumicën e rasteve AQP-ja nuk i kishte analizuar kontratat individuale të institucioneve për të parë çmimet me të cilat ato furnizoheshin. Meqë kontratat nuk ishin monitoruar si duhet dhe nuk kishte pasur masa parandaluese, furnitorët mund të

kërkojnë kompensim prej 2.6 milion eurosh për mallrat që janë kontraktuar por nuk janë porositur. Raportimi i rrallë dhe analizimi edhe më i rrallë i këtyre raporteve ka rezultuar me mungesë të informatave lidhur me progresin e kontratave dhe ka çuar në mungesë të masave korrigjuese.

Efikasiteti dhe efektiviteti i politikave të punësimit. Shkalla e papunësisë në vend është në nivel të lartë, prandaj politikat në nivel qeveritar dhe sektorial duhet të shërbejnë si përgjigje ndaj gjendjes së krijuar të papunësisë në vend. Kjo mund të arrihet përmes një planifikimi adekuat të kapaciteteve të nevojshme njerëzore e financiare për implementim të politikës si dhe përmes krijimit të mekanizmave të qëndrueshëm monitorues.

Menaxhimi financiar dhe kontrollet e borxheve publike për periudhën 2009-2017. Borxhi publik është në trend të rritjes. Në vitin 2009 ishte 6.12 % përdërisa në vitin 2017 arriti nivelin prej 16.63% të BPV. Ndonëse niveli i borxhit aktual nuk paraqet ndonjë kërcënim për stabilitetin financiar të shtetit, shqetësuese është aftësia e dobët e organizatave zbatuese të projekteve në shfrytëzimin me kohë të këtyre fondeve. Në mungesë të përgatitjeve të duhura për fillimin e ekzekutimit të projekteve, rreth 296 mil € nuk janë tërhequr (shpenzuar) sipas marrëveshjeve të arritura me institucionet financiare ndërkombëtare, edhe pse kanë qenë në dispozicion për t'u përdorur.

Tregues performance për nivelin lokal qeverisës për vitin 2017. Komunitat nuk kanë qenë plotësisht transparente dhe llogaridhënëse ndaj tatimpaguesve dhe palëve të interesit. Mangësi kishte edhe në raportim. Mungon një kulturë vetëkritike dhe krahasuese në qeverisjen e organizatave buxhetore lokale mbi efektivitetin, efikasitetin dhe ekonomizimin e transaksioneve ekonomike karshi shërbimeve të ofruara/pranuara.

Efektiviteti i programeve të veçanta të banimit. Qeveria nuk ka arritur të krijojë mekanizma të qëndrueshëm që do të ndihmonin në zbatimin, koordinimin dhe

monitorimin e Programeve të Veçanta për Banim. Si pasojë, Programi i Veçantë për Banim nuk funksionon si duhet. Shumica e atyre që kanë nevojë për banim social nuk kanë arritur të përfitojnë dhe shumë qytetarë do të vazhdojnë të jetojnë në objekte të rrezikshme ose të papërshtatshme për banim.

Menaxhimi i të hyrave vetanake në nivelin lokal. Menaxhimi i të hyrave vetanake në nivelin lokal të qeverisjes nuk është duke u zhvilluar kënaqshëm dhe sipas praktikave të mira. Qeveria nuk ka arritur të jetë plotësisht efektive dhe efikase gjatë gjithë procesit, si nga niveli qendror po ashtu edhe nga ai lokal me qëllim të arritjes së objektivave komunale drejt përmirësimit të shërbimeve ndaj qytetarëve.

Vlerësimi i sistemeve të TI në nivelin qendror dhe lokal. Organizatat buxhetore të nivelit qendror dhe lokal kanë mangësi të theksuar në qeverisjen e teknologjisë informative. Rreth 70% e tyre kanë mungesë të strategjisë, politikave dhe procedurave për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve të teknologjisë informative, strukturë jo të përshtatshme organizative të departamentit të Teknologjisë Informative, ndërsa është vlerësuar se vetëm 27% e tyre shfrytëzojnë sistemet informative qendrore.

Menaxhimi i listës esenciale të barnave. Institucionet përgjegjëse nuk kanë arritur të përmbushin plotësisht synimet e parapara

përmes Listës Esenciale të Barnave. Menaxhimi i Listës nuk është bërë në mënyrë efektive dhe efikase. Procesi i planifikimit, shpërndarjes dhe monitorimit të barnave si në nivelin dytësor ashtu edhe në atë tretësor është përcjellë me mangësi. Si pasojë, qytetarët nuk i marrin barnat të cilat u takojnë në kohën kur u nevojiten. Lista esenciale e barnave nuk është azhurnuar që nga viti 2013 dhe ekziston rreziku që barna të rëndësishme dhe me kosto më të ulët mos të jenë në këtë listë. Rreth 30% e barnave nuk porositen asnjëherë, ndërsa ka barna të rëndësishme të cilat janë kërkuar në vazhdimësi, mirëpo nuk janë përfshirë në listën esenciale.

Zbatimi i rekomandimeve për pajisjet mjekësore, rasti: “Tomografia e Kompjuterizuar”. Auditimi përcjellës nxjerrë në pah se asnjë nga rekomandimet e dhëna në vitin 2015 nuk janë adresuar plotësisht, shtatë (7) rekomandime janë zbatuar pjesërisht dhe tri (3) rekomandime nuk janë zbatuar fare. Për pasojë, menaxhimi dhe monitorimi i pajisjeve mjekësore, me theks Tomografitë e Kompjuterizuara, të vendosura në QKUK dhe spitalet e përgjithshme, vazhdojnë të përcillen me mangësi thelbësore duke rrezikuar kështu profesionalizmin e stafit mjekësor dhe duke rritur rrezikun e dhënies së diagnozave të pasakta për qytetarët e vendit.

1.3.4 Kontrolli i cilësisë

Kontrolli i cilësisë

Me qëllim të ngritjes së cilësisë së auditimeve në një nivel sa më të lartë, ZKA ka të themeluar Departamentin e Metodologjisë dhe të Kontrollit të Cilësisë. Ky departament, i cili vepron në pajtim me SNISA 40 (Kontrolli i cilësisë), kryen rishikimin e auditimeve të realizuara, duke u siguruar se gjatë kryerjes së punës ekipet e auditimit kanë zbatuar në plotësi SNISA-t si dhe Doracakun e Auditimeve, të aprovuar nga AP. Përzgjedhja e auditimeve për rishikim nga ky departament, bëhet duke pasur parasysh madhësinë, kompleksitetin e auditimeve, si dhe duke konsideruar mbulueshmërinë e të gjitha ekipeve të auditimit me rishikim.

Për sezonin 2017/2018, janë kryer 38 rishikime të auditimeve të rregullsisë në të gjitha fazat e auditimit, kurse për sezonin 2018/2019 është planifikuar të rishikohen 45 auditime të rregullsisë. Në këtë mënyrë, ZKA sigurohet që të gjitha ekipet e auditimit zbatojnë kërkesat e SNISA-ve, të metodologjisë së auditimit të definuar në doracakët përkatës dhe letrat e punës si dhe kanë një qasje konsistente në auditim.

Për sa i përket auditimeve të performancës, monitorimi dhe kontrolli i cilësisë është një proces që zbatohet në çdo auditim. Fazat e planifikimit, ekzekutimit dhe raportimit të auditimit janë subjekt i rishikimit në të gjitha nivelet menaxheriale. Rishikimi kolegjial për draft raportin e auditimit bëhet nga anëtarët e emëruar përbrenda divizionit, përpara se të shqyrtohet draft raporti nga menaxhmenti. Parastudimet dhe draft raporti rishikohen në mënyrë sistematike përmes diskutimeve brenda ekipit, nga udhëheqësi i departamentit dhe menaxhmenti i lartë. Për disa nga temat janë angazhuar këshilltarë të jashtëm nga Zyra Kombëtare e Auditimit e Suedisë (SNAO), Banka Botërore (BB) dhe në disa raste edhe ekspertë vendorë të fushave përkatëse.

1.4 Menaxhimi Financiar, Pasuritë dhe Shërbimet Mbështetëse

Treguesi kryesor tek kjo fushë është: **menaxhimi financiar, pasuritë** dhe **shërbimet mbështetëse**. ZKA, burim kryesor të financimit ka Buxhetin e Republikës së Kosovës. Përveç kësaj, ZKA pranon donacione dhe grante të ndryshme për të mbështetur aktivitetet dhe funksionet e saj. Gjatë vitit 2018, ZKA ka bashkëpunuar me partnerë të ndryshëm ndërkombëtarë, siç janë Banka Botërore, USAID dhe institucionet supreme të auditimit që në një mënyrë apo tjetër kanë përkrahur ZKA-në në përmbushjen e synimeve strategjike.

1.4.1 Menaxhimi financiar i ZKA-së

Me Ligjin e Buxhetit për vitin 2018, ZKA-së i është ndarë buxheti i përgjithshëm prej 2,790,883€. Krahasuar me vitin 2017, ndarja fillestare buxhetore për vitin 2018, ishte më e madhe për 16%. Kjo rritje është bërë në emër të përkrahjes së zhvillimit të vazhdueshëm profesional të institucionit dhe kryerjes së më shumë auditimeve me kapacitete vetanake. Buxheti final për 2018 ishte 2,743,518€. Krahasuar me vitin me 2017, ndarja finale buxhetore për vitin 2018, ishte më e madhe për 15%. ZKA është duke u përkrahur edhe nga Banka Botërore përmes projektit "Fuqizimi i kapaciteteve të Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e prokurimit", zbatimi i të cilit ka filluar simbolikisht gjatë vitit 2017 dhe do të përfundojë në shtator 2019. Vlera e projektit është 164,930€.

ZKA kontribuon edhe me realizimin e të hyrave buxhetore nga auditimet e projekteve të financuara nga donatorët. Fondet e gjeneruara janë derdhur drejtpërdrejt në Buxhetin e Kosovës.

Menaxhimin e buxhetit, ZKA e bënë në përputhje me rregullat dhe procedurat përkatëse për menaxhimin financiar dhe kontrollin. Në vazhdim janë paraqitur ndarjet buxhetore sipas kategorive ekonomike dhe ndryshimet që kanë ndodhur gjatë vitit.

Pagat dhe mëditjet. Shuma e miratuar për këtë kategori ekonomike ishte 2,019,594€. Krahasuar me vitin 2017, ndarja buxhetore për vitin 2018, ishte më e madhe për 13%. Në rritjen e buxhetit për Paga dhe Mëditje ka ndikuar kryesisht shtimi i numrit të punonjësve për 7 persona. Qeveria e Kosovës ka bërë reduktimin e mjeteve për 16,898€ dhe pas këtij reduktim, mjetet në këtë kategori ishin 2,002,696€. Ky buxhet është realizuar tërësisht deri në fund të vitit 2018.

Mallrat dhe shërbimet. Ndarja buxhetore për këtë kategori ishte 651,289€. Krahasuar me

buxhetin final të vitit 2017, ndarja për vitin 2018 ishte më e madhe për 14.8%. Rritjen e shpenzimeve në këtë kategori e kanë shkaktuar kryesisht ndërrimi i objektit për punë të ZKA-së dhe rritja e numrit të auditimeve. Në fund të vitit shuma e shpenzuar për këtë kategori ishte 612,955€, ose në përqindje 94%.

Në kuadër të projektit të financuar nga Banka Botërore "Fuqizimi i kapaciteteve të ZKA për auditimin e prokurimit", gjatë vitit 2018 janë realizuar 18,862.75€ për angazhimin e ekspertizës ndërkombëtare në përkrahje për

fuqizimin e kapaciteteve të ZKA-së në fushën e prokurimit.

Shërbimet komunale. Ndarja buxhetore për këtë kategori ekonomike ishte 45,000€. Krahasuar me vitin 2017, ndarja buxhetore për vitin 2018, ishte më e madhe për 32%. Qeveria e Kosovës ka reduktuar shumën prej 9,085€ dhe pas këtij reduktimi, mjetet në këtë kategori ishin 35,915€. Në fund të vitit, buxheti i shpenzuar ishte 30,038€, ose në përqindje prej 84%.

Investimet kapitale. Ndarja buxhetore për këtë kategori ishte 75,000€. Në pamundësi të realizimit të projektit "Softuer për mbështetje të auditimit", ZKA ia ka paraqitur Qeverisë së Kosovës shumën prej 21,382€ si kursime buxhetore. Buxheti final për këtë kategori në fund të vitit ishte 53,618€ dhe krahasuar me vitin paraprak shënon rritje për 41,358€. Kurse buxheti i shpenzuar ishte 50,773€, ose në përqindje 95%.


Siç mund të shihet nga Tabela 6 dhe përmes ilustrimit në Grafikon 8, më poshtë, niveli i shpenzimeve kryesore të ZKA-së të realizuara gjatë tri viteve të fundit në raport me buxhetin e përgjithshëm, është pothuajse i njëjtë, me kategorinë e Pagave dhe Mëditjeve që tërheqë rreth ¾ e buxhetit të ZKA-së. Edhe tek Mallrat dhe Shërbimet është situata e njëjtë - në tri vitet e fundit këto shpenzime përbëjnë rreth ¼ e buxhetit të përgjithshëm të ZKA-së. Shpenzimet për investime kapitale dhe shërbime komunale janë në shifra jo-materiale.

Tabela 6. Shpenzimi i buxhetit përgjatë tri viteve 2016-2018 (në EUR `000)


Raporti i buxhetit	Buxheti fillestar	Buxheti final	Buxheti i shpenzuar	%
2018				
Buxheti i përgjithshëm	2,791	2,744	2,697	98
Pagat dhe mëditjet	2,020	2,003	2,003	100
Mallrat dhe shërbimet	651	651	613	94
Shërbimet komunale	45	36	30	84
Investimet kapitale	75	54	51	95
2017				
Buxheti i përgjithshëm	2,398	2,603	2,327	89
Pagat dhe mëditjet	1,768	1,768	1,757	99
Mallrat dhe shërbimet	551	788	530	67
Shërbimet komunale	34	34	28	81.5
Investimet kapitale	45	13	12	94
2016				
Buxheti i përgjithshëm	2,309	2,264	2,235	99
Pagat dhe mëditjet	1,674	1,704	1,690	99
Mallrat dhe shërbimet	551	521	507	97
Shërbimet komunale	34	26	25	96
Investimet kapitale	50	13	13	100

Shpenzimet e buxhetit të ZKA-së gjatë vitit 2018, janë pasqyruar në Grafikon 9. Shpenzimet e realizuara tregojnë Pagat dhe Mëditjet si kategorinë me shpenzimin më të madh të buxhetit prej 74%, Mallrat dhe Shërbimet marrin pjesë me 23%, Investimet kapitale me 2%, ndërsa Shpenzimet komunale me vetëm 1%.

Grafiku 8. Shpenzimet kryesore gjatë tri viteve të fundit (2016-2018)




Grafiku 9. Shpenzimet buxhetore nëpër kategoritë ekonomike për vitin 2018



Grafiku 10, më poshtë, pasqyron shpërndarjen e shpenzimeve të kategorisë ekonomike për Mallra dhe Shërbime. Shpenzimet më të rëndësishme tek kjo kategori janë:

- **Qiraja** e objektit përbën shpenzimin më të madh tek kjo kategori, pasi që ZKA ende kryen aktivitetin e saj në një objekt privat. Pas përfundimit të kontratës për shfrytëzimin e objektit paraprak, për shkak të rritjes së numrit të punonjësve dhe pamundësisë për t'i akomoduar të gjithë personelin në një vend, ZKA ka ndërruar lokacion dhe është vendosur në një objekt të vetëm. Objekti i ri ofron kushte më të përshtatshme për punë dhe e bën veprimtarinë e ZKA-së më të lehtë dhe më të qasshme për palët. Shpenzimet e qirasë përbëjnë 28% të shpenzimeve të përgjithshme të kësaj kategorie.
- **Pajisjet dhe furnizimet për zyrë** përfshijnë pagesat për blerje të pajisjeve dhe furnizime të tjera për nevoja të ZKA-së. Ato përbëjnë 22% të shpenzimeve të përgjithshme në këtë kategori.
- Për **udhëtimet zyrtare** brenda dhe jashtë vendit janë shpenzuar 19% e buxhetit të kësaj kategorie. Këto shpenzime janë ndikuar nga rritja e portofolit të auditimeve, kryesisht përfshirjes më të madhe të ndërmarrjeve publike dhe të auditimeve të performancës. Gjatë vitit 2018 kishte pjesëmarrje aktive të personelit të ZKA-së në aktivitete të ndryshme me karakter të zhvillimit profesional, punëtori, konferenca dhe seminare ndërkombëtare jashtë vendit.
- Për **mirëmbajtje dhe sigurim** janë shpenzuar 11% e buxhetit të kategorisë. Këtu përfshihen shpenzimet për mirëmbajtje dhe sigurim të objektit, të teknologjisë informative dhe të veturave zyrtare të ZKA-së.
- Për **shtypjen dhe publikimin e raporteve** të ZKA-së dhe dokumenteve tjera, janë shpenzuar po ashtu 11% e buxhetit të kategorisë. Në këtë kuadër përfshihen shpenzimet për shtypjen e raporteve vjetore, të performancës, si dhe raportet tjera që prezantojnë punën e ZKA-së.

Grafiku 10. Shpenzimet kryesore në kategorinë Mallra dhe shërbime



1.4.2 Shërbimet Mbështetëse

Shërbimet mbështetëse të ZKA-së, përbëhen nga katër njësitë operative në vijim:

- Departamenti për Buxhet dhe Burime Njerëzore
- Departamenti për Shërbime të Përbashkëta
- Departamenti për Teknologji Informative, dhe
- Njësia e Prokurimit.

Shërbimet e Përbashkëta. Gjatë vitit 2018, kjo njësi ka përmbytur nevojat dhe kërkesat institucionale duke kryer punë të mbështetjes teknike-administrative dhe të logjistikës. Duhet veçuar angazhimet në përgatitjen teknike të objektit të ZKA-së, në të cilin gjatë muajit gusht është vendosur personeli i ZKA. Po ashtu, në përputhje me planin e bartjes dhe akomodimit, janë kryer të gjitha shërbimet e nevojshme për një transferim më të lehtë dhe më të shpejtë të pasurisë dhe vendosjes së personelit të ZKA-së në zyrat e reja. Objekti i marrë me qira (në lagjen Arbëria) ka hapësirë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për punë. Posedon salla për takime dhe trajnime si dhe hapësirë adekuate për arkivim të dokumentacionit.

Përfundimi i kontratës paraprake për qiranë e objektit dhe domosdoshmëria për akomodim në një objekt tjetër, ka imponuar nevojën për marrjen e disa veprimeve shtesë të prokurimit që nuk kanë qenë pjesë e planit fillestar vjetor të prokurimit dhe të cilat janë prezantuar edhe në raportin e auditimit.

Me qëllim të kryerjes së punëve audituese në terren (selinë e entiteteve të audituara), ZKA është furnizuar me dy automjete të reja, të cilat janë vënë në funksion dhe shërbejnë për bartjen e personelit tek entitetet të cilat janë pjesë e planit auditues të ZKA-së.

Teknologjia Informative. Meqenëse teknologjia po ndryshon shumë shpejtë dhe kapaciteti i informacionit që ruhet në formë elektronike po rritet gjithnjë e më shumë, nevojat për pajisje të reja dhe rifreskimin e atyre ekzistuese janë të vazhdueshme. Gjatë vitit 2018 është bërë rifreskimi i ¼ së infrastrukturës dhe pajisjeve të TI-së. Me kalimin e ZKA-së në objektin e ri, është përgatitur infrastruktura ekzistuese e teknologjisë informative për nevojat e institucionit, është bërë bartja e të gjitha pajisjeve, si dhe janë kryer testimet dhe përforcimet e nevojshme.

Bazuar në Planin strategjik të ZKA-së, ka filluar puna për përgatitjen e Strategjisë së TI-së. Personeli i TI-së është mbështetur edhe nga këshilltarët e SNAO. Fillimisht është bërë vlerësimi i gjendjes aktuale dhe janë dhënë propozime duke u bazuar në disa praktika të mira për përmirësime të mëtejshme. Sfidë në fushën e TI-së mbetet zbatimi i kërkesave për shkak të ndërrimeve të shpejta në këtë fushë, ruajtja, sigurimi dhe përcjellja e njohurive të reja.

Prokurimi. Gjatë vitit 2018, janë realizuar 86 procedura të prokurimit. Procedurat kanë qenë kryesisht për furnizime dhe shërbime.

Përmes një konkursi publik, ZKA ka përzgjedhur Logon e institucionit, siç është paraqitur në Figurën 1.

Figura. 1 Logoja e ZKA-së



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Gjatë vitit 2018, ZKA ka dizajnuar logon e saj institucionale, e cila paraqet **“veglën e sitës”** apo rrjetën që pengon depërtimin e grimcave të panevojshme apo të dëmshme. Logoja paraqet, përmes metaforës, konceptin e punës së ZKA-së, që ndërlidhet me vizionin dhe misionin e ZKA-së.

1.5 Menaxhimi i burimeve njerëzore

Treguesit kryesorë tek kjo fushë janë **menaxhimi i burimeve njerëzore** dhe **zhvillimi profesional**.

1.5.1 Burimet njerëzore

Gjatë vitit 2018, në fushën e menaxhimit të burimeve njerëzore, janë ndërmarrë një sërë aktivitete që ndërlidhen me marrëdhënien e punës, zhvillimin profesional, mirëqenien në punë dhe vlerësimin e performancës së punonjësve të ZKA-së. Sipas Ligjit të Buxhetit për vitin 2018, ZKA kishte të miratuara 167 vende të punës, prej të cilave janë plotësuar 165. Tabela 7, më poshtë pasqyron strukturën gjinore të personelit, ku shihet se ka një rritje të lehtë në favor të gjinisë femërore, në krahasim me vitin 2017. Pra, sipas shënimeve në fund të vitit, struktura gjinore e personelit është 51% femra dhe 49% meshkuj. Lëvizja e punonjësve ka pësuar ulje të lehtë nga 2.5 në 1.8, më e ulët për 0.6%, në krahasim me vitin 2017. Po ashtu, numri i punonjësve nga komunitetet nuk ka ndryshuar nga viti i kaluar.

Tabela 7: Ndryshimet në personelin e ZKA-së, përgjatë tri viteve të fundit

Viti	Tavani buxhetor i personelit (numër)	Personeli femëror (%)	Mosha Mesatare (vite)	Personel nga komunitetet (numër)	Lëvizja e personelit (%)
2018	167	51	40.4	4	1.8
2017	160	50	39.6	4	2.5
2016	146	50	39	5	0

Për sa i përket strukturës së moshës së punonjësve të ZKA-së, dominon moshja e mesme prej 31 deri në 50 vjet që në përqindje shprehet prej 77%, moshja e re 7%, derisa ajo e shtyrë është 16%. Ky është një tregues i rëndësishëm që ZKA është një institucion me kompetencë dhe përvojë të mirë profesionale dhe se ka potencial për zhvillim të mëtejshëm profesional.

Tabela 8: Pozitat drejtuese sipas gjinisë në të gjitha funksionet

Viti	Gjithsej femra në pozita udhëheqëse (numër)	Përqindja %	Gjithsej meshkuj në pozita udhëheqëse (numër)	Përqindja %
2018	32	44	40	56
2017	33	46	39	54
2016	25	42	35	58

Tabela 8, më sipër prezanton strukturën gjinore të pozitave udhëheqëse në ZKA, ku përfshihen, nivelet drejtuese, niveli i mesëm drejtues dhe pozitat e udhëheqësve të ekipeve të auditimit. Pjesëmarrja e personelit femëror në pozitat udhëheqëse gjatë tri viteve të fundit, ka qenë mbi 40%.

Në fund të vitit 2018, ZKA ka pasur gjithsej 165 punonjës, prej tyre 138 apo 84% personel auditues (përfshirë pozitat menaxheriale), kurse pjesa tjetër prej 27 punonjësve apo 16% janë shërbyes civil dhe punonjës mbështetës.

Rekrutimet. Gjatë vitit 2018, ZKA ka përzgjedhur nëntë (9) punonjës të rinj, derisa numri i atyre që kanë lëshuar punën në ZKA është tre (3). Rrjedhimisht, numri i punonjësve në ZKA është rritur për gjashtë (6), në krahasim me vitin 2017. Për të mbështetur këto ndryshime janë realizuar dhjetë (10) procese të rekrutimit. Në këtë kuadër përfshihet edhe procesi rekrutues i përkthyesve të përkohshëm, për të përkrahur përkthimin e raporteve të auditimit. Këta përkthyes janë angazhuar në cilësinë e kryesve të shërbimeve dhe të njëjtit me përfundimin e punës së përcaktuar kanë përfunduar edhe angazhimin e tyre në ZKA.

1.5.2 Zhvillimi profesional dhe trajnimi i personelit

Përgatitja e Planit vjetor të trajnimeve për personelin auditues është përgjegjësi e Njesisë së Metodologjisë në Auditim të ZKA-së, e cila në koordinim me Divizionin e Burimeve Njerëzore, realizon të gjitha aktivitetet e përcaktuara. Derisa për planin e trajnimit për punonjës të mbështetës përgatitet plan i veçantë në përputhje me legjislacionin në fuqi të shërbimit civil.

Gjatë vitit 2018, ZKA ka organizuar rreth 50 aktivitete që ndërliken me zhvillimin profesional dhe trajnimin. Janë mbajtur mbi 30 aktivitete trajnuese të brendshme, kryesisht me tematikë nga fusha e auditimit.

Në krahasim me vitin 2017, numri dhe struktura kualifikuese e punonjësve auditues ka pësuar ndryshim, ku një numër i konsiderueshëm i tyre kanë kryer nivelet përkatëse të certifikimit sipas skemave të përcaktuara. Rrjedhimisht, numri i auditorëve të certifikuar është duke u rritur në vazhdimësi.

Personeli i ZKA-së ka marr pjesë edhe në trajnime jashtë vendit, ku veçohet përkrahja e Zyrës Kombëtare të Auditimit të Suedisë (SNAO) në aftësimin punonjësve të ZKA-së të nivelit drejtues dhe punonjësve auditues. SNAO ka mbështetur zhvillimin profesional të auditorëve për auditime të rregullsisë, të performancës dhe të pajtueshmërisë, si dhe janë zhvilluar trajnime për menaxhim dhe leadership për udhëheqësit e departamenteve të auditimit dhe udhëheqësit e ekipeve. Në kuadër të bashkëpunimit bilateral janë realizuar një sërë prezantimesh, tryeza

pune dhe seminare nga fushat profesionale të auditimit. Në veçanti, përkrahja e SNAO-s është realizuar përmes këshilldhënies dhe punës praktike, në raste të caktuara.

Për herë të parë auditorët e ZKA janë përfshirë në programin e punës praktike profesionale në Institucionin Suprem të Auditimit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (GAO). Dy auditorë të ZKA-së kanë ndjekur për tre muaj këtë program.

Personeli i ZKA-së ka përfituar edhe nga bashkëpunimi me donatorët në Kosovë. Në kuadër të projektit të USAID "Komuna transparente, efektive dhe të përgjegjshme (TEAM)", ZKA-së i është ofruar përkrahje në ngritjen e kapaciteteve dhe metodologjisë për zbulimin e mashtrimit në fushën e prokurimit.



1. Trajnimi me udhëheqësit e departamenteve dhe 2. Trajnimi me udhëheqësit e ekipeve

Përkrahje në fuqizimin e kapaciteteve të ZKA-së është dhënë edhe përmes projektit "Fuqizimi i kapaciteteve të ZKA për auditim të prokurimit", ku është angazhuar një ekspert me përvojë shumëvjeçare në auditimin e prokurimit. Deri më tani janë organizuar disa sesione trajnuese, ku kanë marrë pjesë niveli drejtues auditues dhe niveli auditues i fushës së prokurimit dhe auditimit të performancës. Me ekspertin e angazhuar nga BB, janë mbajtur edhe trajnime në lidhje me përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë në formulimin e gjetjeve dhe rekomandimeve të auditimit.

1.6 Komunikimi dhe Bashkëpunimi me Palët e Interesit

ZKA angazhohet që në mënyrë aktive të zhvilloj komunikim dhe dialog të hapur me të gjitha palët e interesit. Kjo qasje i ka siguruar ZKA-së një informacion më të plotë mbi pritjet dhe nevojat për bashkëveprim të përditshëm me partnerët tanë dhe e ka ndihmuar ZKA-në që të ofrojë informata relevante dhe të azhurnuara.

Gjatë vitit 2018 ZKA ka zhvilluar më tutje qasjen e saj gjithëpërfshirëse duke qenë nikoqir, si edhe pjesëmarrës në shumë takime, punëtori e konferenca të organizuara brenda dhe jashtë vendit.

Treguesit kryesorë tek kjo fushë janë **Komunikimi me Legjislativin, Ekzekutivin dhe Gjyqësorin; Komunikimi me Mediat, Qytetarët dhe Organizatat e Shoqërisë Civile; dhe Bashkëpunimi me ISA-të partnere dhe Donatorët.**

1.6.1 Komunikimi me Legjislativin, Ekzekutivin dhe Gjyqësorin

Gjatë vitit 2018, përmes punës me komisionet parlamentare, në veçanti Komisionin për Mbikëqyrje të Financave Publike dhe Komisionin për Buxhet dhe Financa, është intensifikuar edhe më tej bashkëpunimi me Kuvendin e Kosovës. ZKA ka ndërmarrë veprime të caktuara për të ofruar gjithë mbështetjen e nevojshme për deputetët në shqyrtimin e raporteve të auditimit. Për këtë qëllim, ZKA ka organizuar tri tryeza të veçanta me anëtarët e Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe atij për Mbikëqyrje të Financave Publike ku në mënyrë të specifikuar janë trajtuar gjetjet dhe rekomandimet që kanë rezultuar nga veprimtaria audituese e që kanë për synim përmirësimin e menaxhimit të financave publike në Kosovë.

Për më tepër në vitin 2018, Kuvendi i Kosovës, përkatësisht komisionet parlamentare: KMFP dhe KBF ka shqyrtuar 33 raporte të auditimit të rregullsisë dhe të performancës për organizatat buxhetore dhe për ndërmarrjet publike, ndërsa Auditori i Përgjithshëm ka prezantuar në seancë plenare gjetjet dhe rekomandimet nga RVA për vitin 2017. Me këtë rast, ai ka kërkuar vëmendjen e deputetëve dhe të krerëve të institucioneve publike, për çështjet e ngritura në raport për sa i përket llogarive të arkëtueshme, detyrimeve të papaguara dhe detyrimeve kontigjente si dhe regjistrimin, prezantimin dhe trajtimin e pasurive.

Fotogaleria 3. Takimet me Kuvendin dhe KMFP



1. AP paraqet në seancë plenare Raportin Vjetor të Auditimit për vitin fiskal 2017; 2. Pjesëmarrja e përfaqësuesve të ZKA-së në mbledhjet e KMFP, gjatë rishikimit të raporteve të auditimit.

Fotogaleria 4. Vizita e deputetëve të Kuvendit të Kosovës në selinë e ZKA-së



1. Vizita e KMFP në zyrat e ZKA; 2. Takim i përbashkët i ZKA me komisionet parlamentare: KMFP dhe KBF.

Pas paraqitjes së RVA-së për vitin 2017 nga AP, Kuvendi i Kosovës, miratoi rekomandimet e KMFP-së për t'i kërkuar Qeverisë së Kosovës që të zbatojë të gjitha rekomandimet e dala nga Raporti Vjetor i Auditimit për vitin 2017 dhe të raportoj me shkrim në Kuvend në fund të çdo tremujori të vitit 2019 për ecurinë e zbatimit të këtyre rekomandimeve.

Bashkëpunimi me përfaqësuesit e lartë të institucioneve publike të vendit ka vazhduar përmes komunikimit të rregullt dhe takimeve sipas nevojës ku janë prezantuar çështjet kryesore të auditimit për vitin 2017 dhe progresi në zbatimin e rekomandimeve të dhëna në raportet e auditimit. Brenda kompetencave institucionale, kujdes i veçantë i është kushtuar bashkëpunimit profesional me Thesarin. Komunikimi i rregullt ndërmjet dy institucioneve ka bërë që të evidentohen me kohë dhe të shmangen një sërë gabimesh në raportimin financiar të OB.



1. Takimi me zyrtarët kryesorë financiar të OB; 2. Takim me drejtorët e financave të NP-ve të audituara.

AP ka bashkëpunim të rregullt institucional edhe me organet e drejtësisë dhe organizmat përkatëse për luftimin e korrupsionit, si me: **Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit**, duke e informuar në lidhje me rastet indikative me elemente të veprave penale të cilat hasen gjatë punës audituese; **Agjencinë Kundër Korrupsionit**, duke ofruar informata shtesë dhe sqarime sipas nevojës lidhur me trajtimin e gjetjeve në raportet e auditimit; dhe **Policinë e Kosovës**, duke i ofruar të dhëna dhe dokumente relevante të siguruara në proceset e auditimit për rastet e caktuara të cilat trajtohen nga hetuesia.

Me mbështetjen e USAID, ZKA ka intensifikuar angazhimin e vet në forcimin e kapaciteteve për luftimin e mashtrimit dhe korrupsionit përmes auditimit. Për këtë qëllim, me 21 maj 2018, u nënshkrua Memorandumi i Mirëkuptimit në mes të ZKA dhe USAID i cili fokus kryesor ka mbështetjen e ZKA-së për themelimin e Njesisë për luftimin e mashtrimeve.

ZKA, në raport me organet e drejtësisë dhe organizmat përkatëse për luftimin e korrupsionit, vepron në përputhje të plotë me standardet ndërkombëtare të auditimit dhe me legjislacionin kombëtar të fushës penale.

1.6.2 Komunikimi me Mediat, Qytetarët dhe Organizatat e Shoqërisë Civile

Në pajtim me parimet e SNISA (20 dhe 12), ZKA edhe gjatë vitit 2018 ka zhvilluar dhe inkurajuar bashkëpunim të ngushtë me qytetarët, shoqërinë civile dhe mediat. Kjo qasje ka nxitur transparencën dhe rritur llogaridhënien. Ueb-faqja e ZKA-së, si burimi kryesor i informacionit, ofron të dhëna të azhurnuara sa i përket të gjitha raporteve të auditimit dhe institucionin në përgjithësi. ZKA është angazhuar në vazhdimësi që përdorimi i saj të jetë i lehtë dhe i përshtatshëm për të gjithë përdoruesit dhe në platforma të ndryshme elektronike. Gjatë vitit

2018 janë numëruar rreth 172,000 vizita, një numër i konsiderueshëm prej të cilëve janë vizitorë të rinj dhe rreth 18,520 përdorues.

Në vitin 2018, komunikimi dhe bashkëpunimi me organizatat e shoqërisë civile është rritur përmes takimeve periodike, informimit të vazhdueshëm dhe organizimit të prezantimeve publike për raportet e auditimit të performancës. Gjithashtu, mbështetje të vazhdueshme është dhënë në ofrimin e informatave të kërkuara nga organizatat e shoqërisë civile përmes pyetësorëve dhe anketave, për qëllime të analizave dhe studimeve të tyre si dhe pjesëmarrjes në konferenca dhe punëtori të organizuara nga ato.

AP dhe zëvendës AP kanë marrë pjesë në të gjitha debatet e organizuara nga organizata BIRN, nëpër kuvendet komunale (Prizren, Pejë, Gjilan, Kamenicë, Shtime), ku në prezencë të kryetarit të komunës, të këshilltarëve komunal, të përfaqësuesve të shoqërisë civile dhe të mediave është diskutuar për progresin në zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

Fotogaleria 6. Takimet nëpër kuvendet komunale, me BIRN



1. Takimi me udhëheqjen komunale të Kamenicës; 2. Takimi me udhëheqjen komunale të Pejës.

1.6.3 Bashkëpunimi me ISA-të partnere dhe donatorët

Për të siguruar se funksionet tona institucionale i zhvillojmë në harmoni me trendët ndërkombëtare, ZKA fokusohet në mirëmbajtjen e marrëdhënieve të mira dhe bashkëpunimit me organizatat homologe. ZKA tashmë ka një histori të bashkëpunimit me institucionet si-motra nga rajoni dhe më gjerë, ndërsa në vazhdimësi ka rritur bashkëpunimin edhe me organizatat rajonale e globale në fushën e auditimit. Edhe pse jemi pjesë aktive e këtyre organizatave dhe grupimeve, ZKA-ja në aktivitetet ndërkombëtare përfaqësohet në cilësinë e vëzhguesit, prandaj objektivë strategjike në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar është anëtarësimi me të drejta të barabarta në organizatat përkatëse, proces ky që tashmë ka filluar.

Gjatë vitit 2018, AP ka zhvilluar takime bilaterale me: z. **Gene Dodaro**, Auditor i Përgjithshëm i Shteteve të Bashkuara të Amerikës; z. **Seyit Ahmet Baş**, President i Organizatës Evropiane të ISA-ve (EUROSAI) dhe Gjykatës Turke të Llogarive, z. **Rimantas Šadžius**, Anëtar i Gjykatës Evropiane të Auditorëve, znj. **Helena Lindberg**, Auditore e Përgjithshme e Suedisë, z. **Krzysztof Kwiatkowski**, President i Zyrës Supreme të Auditimit të Polonisë, z. **Miloslav Kala**, President i Zyrës Supreme të Auditimit të Çekisë; z. **Tzvetan Tzvetkov**, President i Zyrës Kombëtare të Auditimit të Bullgarisë, etj.

Fotogaleria 7. Takimet me AP të SHBA-së dhe Presidentin e EUROSAL-t



1. Takimi me Gene Dodaro, AP i SHBA-ve; 2. Takimi me Seyit Ahmet Baş, President i Organizatës Evropiane të ISA-ve (EUROSAL) dhe Gjykatës Turke të Llogarive

Ndërsa, përfaqësues dhe auditorë të ZKA-së kanë marrë pjesë në grupe punuese të auditimit në kuadër të bashkëpunimit bilateral dhe rajonal, aktivitete të ndryshme të organizatave profesionale si, Organizata Evropiane e ISA-ve (EUROSAL), Gjykata Evropiane e Auditorëve (ECA); Institucioni Suprem i Auditimit Amerikan (GAO), Komiteti i Kontaktit (ISA-të e vendeve anëtare të BE-së), Rrjeti i ISA-ve të vendeve candidate dhe atyre potencialisht candidate të BE-së. Ndër to vlen të përmenden:

- Pjesëmarrja në Konferencën e nivelit të lartë "Roli i Institucioneve Supreme të Auditimit në përmirësimin e llogaridhënies, transparencës dhe integritetit në Sektorin Publik", organizuar nga Zyra Kombëtare e Auditimit të Bullgarisë, nën Presidencën Bullgare të Bashkimit Evropian.
- Pjesëmarrja në Konferencën Shkencore "Auditimi mbi bazën e rrezikut", organizim i përbashkët i Byrosë Shtetërore të Auditimit të Kuvajtit dhe Kontrollit të Lartë të Shtetit të Shqipërisë.
- Pjesëmarrja në Konferencën Vjetore të Kontrollit të Lartë të Shtetit Shqiptar (KLSH).
- Pjesëmarrja e dy auditorëve të ZKA-së në programin e punës praktike profesionale në Institucionin Suprem të Auditimit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (GAO).
- Pjesëmarrja e një auditori të ZKA-së në programin e punës praktike profesionale në Gjykatën Evropiane të Auditorëve (ECA).

Projekti i Binjakëzimit

Me përkrahjen e Bashkimit Evropian, ZKA ka realizuar bashkëpunimin me Institucionin Suprem të Auditimit të Polonisë, në kuadër të Projektit të Binjakëzimit. Projekti ishte i përqendruar në zhvillimin e qasjes dhe metodologjisë së auditimit të Ndërmarrjeve publike dhe ka rezultuar me përgatitjen e doracakut të auditimit dhe të letrave të punës për auditimit e këtyre entiteteve. Në kuadër të projektit është realizuar edhe një vizitë studimore në ISA të Polonisë.

Fotogaleria 8. Takimet me ISA të Polonisë



1. Përmbyllja e projektit të Binjakëzimit, me prezencën e AP të Polonisë dhe drejtuesve të Zyrës së BE-së në Kosovë; 2. Vizita studimore në ISA të Polonisë

ZKA ka vazhduar bashkëpunimin me institucionet ndërkombëtare dhe organizatat donatore në Kosovë. Përveç projekteve të përmendura më lartë në këtë Raport, ZKA po ashtu ka bashkëpunuar me organizatën gjermane për bashkëpunim ndërkombëtar (GIZ) e cila përkrahë Kuvendin e Kosovës, në veçanti komisionet parlamentare: KMFP dhe KBF; me Zyrën Zvicerane për Bashkëpunim në kuadër të projektit Decentralizimi dhe Përkrahja Komunale – (DEMOS), i cili fokusohet në përkrahjen e komunave të Kosovës; si dhe me OSBE-në, misioni në Kosovë, në organizimin e aktiviteteve me komunat për të adresuar nivelin e ulët të zbatimit të rekomandimeve të auditimit.

1.6.4 Konferenca tematike dhe shënimi i 15-të vjetorit të ZKA-së

Me 4 tetor 2018, Zyra Kombëtare e Auditimit të Kosovës ka shënuar 15-të vjetorin e themelimit si Institucion Suprem i Auditimit i Republikës së Kosovës. Me këtë rast, nga 1 deri me 5 tetor 2018 janë organizuar një sërë aktiviteteve me tematikë të zhvillimit profesional, humanitar dhe festiv. Aktiviteti kryesor dhe më i rëndësishëm ishte konferenca ndërkombëtare "Roli dhe ndikimi i Institucioneve Supreme të Auditimit në rikthimin e besimit të publikut në sektorin publik". Auditori i Përgjithshëm ishte i nderuar me pjesëmarrjen në konferencë të përfaqësuesve të lartë të Institucioneve Supreme të Auditimit nga Gjykata Evropiane e Auditorëve, EUROSAI, Turqia, Çekia, Suedia, Polonia, Bullgaria, Uells, Kroacia, Arabia Saudite, Mali i Zi, Shqipëria, Maqedonia. Po ashtu, pjesëmarrës në këtë konferencë ishin edhe përfaqësues nga SIGMA, si dhe zyrtarë të lartë nga Kuvendi dhe institucione tjera publike nga vendi.

Kjo konferencë kishte për qëllim të nxjerrë mësim të vlefshme për sa i përket rolit dhe ndikimit që institucionet supreme të auditimit kanë në rritjen e përgjegjësisë në sektorin publik dhe rritjen e besimit të qytetarët. Konferenca ka zhvilluar punimet në dy panele me theks në "Ndikimin e auditimit të performancës për qeverisje më të mirë" dhe se "Si ISA-të duhet të demonstrojnë relevancë të vazhdueshme për shoqërinë, duke kryer auditime të bazuara në rrezik". Rezultatet nga diskutimet në konferencë u vlerësuan lartë nga pjesëmarrësit, ndërsa në numrin e tetorit 2018, të gazetës mujore të Gjykatës Evropiane të Auditorëve u publikua shkrimi autorial i z. Rimantas Šadzius, anëtar i Gjykatës Evropiane të Auditimit për Marrëdhënie Institucionale, i cili së bashku me z. Gene Dodaro, Auditor i Përgjithshëm i SHBA-ve ishin folësit kryesor në konferencë.

Fotogaleria 9. Konferenca tematike “Roli dhe ndikimi i ISA-ve në rikthimin e besimit të publikut në sektorin publik”



Aktivitet tjetër i rëndësishëm në kuadër të shënimit të përvjetorit të ZKA-së ishte edhe trajnimi për auditime të performancës, i organizuar në bashkëpunim me Qendrën për Ekselencë të Institucionit Suprem të Auditimit të SHBA-ve, me përkrahjen edhe të USAID. Pjesëmarrës në këtë aktivitet ishin ekipet e auditorëve të performancës nga Mali i Zi, Bosnja e Hercegovina, Maqedonia, Shqipëria dhe Kosova.

Fotogaleria 10. Trajnimi për auditime të performancës, me GAO (SHBA)



Po ashtu, me iniciativën e grupit të punonjësve dhurues të rregullt të gjakut dhe me mbështetjen e Sindikatës, personeli i ZKA-së, dhuroi gjak në mënyrë vullnetare. Aksioni për dhurimin e gjakut tashmë është bërë traditë dhe ky është viti i pestë me radhë që ZKA zhvillon këtë aktivitet. Numri i dhuruesve ishte 15 për të shënuar simbolikisht 15 vjetorin e institucionit.

Fotogaleria 11. Aksioni i dhurimit të gjakut nga personeli i ZKA-së



2 Fokusi i aktiviteteve gjatë vitit 2019

Në funksion të zbatimit të qëllimeve strategjike të ravijëzuara në Planin strategjik, gjatë vitit 2019 ZKA do të fokusohet në fushat në vijim:

Qëllimi 1: Forcimi i pavarësisë dhe mandatit të ZKA-së, në përputhje me SNISA-të

- Inicimi i ndryshimeve të nevojshme ligjore, në përputhje me SNISA-të
- Përditësimi i dokumenteve të metodologjisë së auditimit
- Pilotimi i auditimeve të pajtueshmërisë dhe atyre të rregullsisë së proceseve të prokurimit të projekteve të donatorëve
- Zhvillimi i mëtejshëm të metodologjisë për përzgjedhjen e auditimeve bazuar në rrezik
- Kontraktimi i softuerit për menaxhimin e auditimit

Qëllimi 2: Zhvillimi dhe forcimi i kapacitetit institucional për të mbështetur auditimin dhe qeverisjen korporative

- Ngritja dhe forcimi i mëtejshëm të kapaciteteve profesionale të personelit për zbatimin e planit strategjik
- Forcimi i mëtejshëm të kontroleve të brendshme institucionale
- Sigurimi i kushteve të përshtatshme dhe mjeteve të nevojshme për punë

Qëllimi 3: Komunikimi, integrimi, ndikimi

- Hartimi i Strategjisë për komunikim efektiv me palët e jashtme dhe publikun, shoqërinë civile dhe mediat
- Intensifikimi i komunikimit me komisionet parlamentare
- Përcjellja e progresit në zbatimin e rekomandimeve dhe publikimi i bazës së të dhënave për rekomandimet e pa adresuara
- Pjesëmarrja aktive në aktivitetet e organizatave profesionale të auditimit dhe angazhimi për anëtarësimin e ZKA-së në organizatat rajonale e globale

3 Llogaridhënia e ZKA-së

Sigurimi i integritetit

Përmes kësaj, ju siguroj se informatat në Raportin Vjetor të Performancës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, përfshirë pasqyrat vjetore financiare janë të sakta, të besueshme, dhe objektive.

Deklarata e Transparencës

Përmes kësaj, siguroj se puna jonë gjatë vitit 2018 është kryer në pajtim me Statutin e Shërbimit Publik dhe Kodin e mirësjelljes së ZKA-së.

Besnik Osmani,

Auditor i Përgjithshëm

SHTOJCAT

Shtojca 1: Portofoli i auditimeve për sezonin 2017/18 dhe 2018/19

Në sezonin e auditimit 2017/2018 janë publikuar **122 raporte** të auditimit, si në vijim:

109 raporte të auditimit të rregullsisë, për:

- Raportin Vjetor të Auditimit për Raportin Financiar Vjetor të Buxhetit të Kosovës të vitit 2017
- Kuvendin e Kosovës, Zyrën e Presidentit dhe Zyrën e Kryeministrit
- 19 Ministri
- 38 Komuna
- 30 Institucione të pavarura, si dhe Doganat e Kosovës dhe Administratën Tatimore të Kosovës (dy agjenci ekzekutive në kuadër të Ministrisë së Financave¹³)
- 9 Ndërmarrje publike:
 - Stacionit i Autobusëve sh.a. Prishtinë
 - Kompania Rajonale e Ujësjetësimit Prishtina sh.a
 - Ndërmarrja Publike Hekurudhat e Kosovës – Trainkos sh.a
 - Aeroporti i Gjakovës sh.a
 - Kompania Rajonale Ujësjetësimit Hidroregjioni Jugor sh.a. Prizren
 - Kompania Regjionale e Mbeturisë Uniteti sh.a, Mitrovicë
 - Kompania për Menaxhimin e Deponive të Kosovës sh.a
 - Kompania Regjionale e Ujitjes Drini i bardhë sh.a dhe
 - Ndërmarrja Publike Hortikultura sh.a.
- 7 projekte të financuara nga donatorët:
 - Efiçenca e energjisë dhe energjia e ripërtëritshme në Kosovë
 - Shëndetësia Kosovare
 - Bujqësia dhe Zhvillimi Rural
 - Përmirësimi i sistemit të arsimit në Kosovë
 - Regjistrimi i pronës së paluajtshme në kadastër (RECAP)
 - Përkrahje për përmirësimin e hartimit (zhvillimit) të politikave në Kosovë, dhe
 - Programi mjedisor i Kosovës – PMK 2016 – 2020.

¹³ Doganat e Kosovës dhe Administrata Tatimore e Kosovës janë agjenci ekzekutive të Ministrisë së Financave, PVF-të e tyre integrohen brenda PVF-ve të MF-së. Mirëpo për shkak se 80% e të hyrave të BK-së mblihen prej tyre, ato janë audituar ndaras nga PFV-të e MF-së.

13 raporte të auditimit të performancës (për fusha të ndryshme, TI, prokurim, projekte)

- Efikasiteti dhe efektiviteti i politikave qeveritare të punësimit
- Lista esenciale e barnave
- Menaxhimi i të hyrave vetanake në nivel komunal
- Vlerësimi i Sistemeve të Teknologjisë Informative
- Zbatimi i rekomandimeve për raportin “Përgjegjësia e monitorimit dhe menaxhimit në përdorimin e pajisjeve mjekësore. Rasti: Tomografia e Kompjuterizuar”
- Efektiviteti i programeve të veçanta për banim
- Tregues performance për nivelin lokal qeverisës për vitin 2017 – Dokument diskutimi
- Menaxhimi financiar dhe kontrollet e borxheve publike për periudhën 2009-2017
- Mekanizmat institucional për rregullimin ligjor, monitorimin dhe raportimin e cilësisë së ajrit
- Vlera për para në prokurimet e centralizuara – Pjesa e parë
- Menaxhimi dhe shfrytëzueshmëria e aplikacionit e-Pasuria
- Efektiviteti i sistemit informativ të tatimit në pronë, dhe
- Menaxhimi i marrëveshjeve të bashkëfinancimit me donatorët dhe rezultatet e arritura.

Ndërsa për sezonin e auditimit 2018/2019 i cili ka filluar në shtator të vitit 2018, ZKA planifikon të përfundoj 131 raporte të auditimit, si në vijim:

116 raporte të auditimit të rregullsisë, për:

- Raportin Vjetor të Auditimit për Raportin Financiar Vjetor të Buxhetit të Kosovës të vitit 2018
- Kuvendin e Kosovës, Zyrën e Presidentit dhe Zyrën e Kryeministrit
- 21 Ministri
- 38 Komuna
- 30 Institucione të pavarura, si dhe Doganat e Kosovës dhe Administratën Tatimore të Kosovës
- 12 Ndërmarrje publike:
 - Trainkos sh.a
 - Hortikultura sh.a Prishtinë
 - KUR Drini i Bardhë sh.a
 - Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë sh.a
 - KUR Hidroregjioni Jugor sh.a
 - Stacioni i Autobusëve sh.a – Prishtinë
 - KRM Uniteti sh.a
 - KUR Prishtina sh.a
 - Telekom i Kosovës sh.a (hera e parë)

- Posta e Kosovës sh.a (hera e parë)
- KRM Pastrimi sh.a, Prishtinë (hera e parë), dhe
- Lotaria e Kosovës sh.a (hera e parë)
- 9 projekte të financuara nga donatorët:
 - Zhvillimi rural dhe agrobujqësor (MBPZHR)
 - Regjistrimi i të dhënave shtetërore kadastrale (AKK)
 - Projekti për përmirësimin e sistemit edukativ të Kosovës (MASHT)
 - Projekti për Shëndetësinë e Kosovës (MSH)
 - Eficenca e energjisë së ripërtëritshme (MZHE)
 - Konkurrueshmëria dhe gatishmëria për eksportim (MTI)
 - Statistikat në vendimmarrje në Kosovë (ASK)
 - Programi Mjedisor i Kosovës, PMK 2016-2020 (MMPH-SIDA), dhe
 - Përkrahja për përmirësimin e hartimit (zhvillimit) të politikave në Kosovë (ZKM-SIDA)

15 auditime të performancës (për fusha të ndryshme, TI, prokurim, projekte)

- Sistemi i kontrollit dhe monitorimit të cilësisë së derivateve
- Ngritja e kapaciteteve në fushën e zhvillimit dhe koordinimit të politikave (Projekti i SIDA-s)
- Çmimi i shërbimeve publike
- Mirëmbajtja në institucionet e arsimit fillor
- Siguria në trafikun rrugor
- Grantet dhe subvencionet në sektorin e bujqësisë
- Cilësia dhe siguria e ushqimit
- Prokurimi publik - kontratat e ndara në llote
- Menaxhimi i kontratave publike
- Monitorimi i investimeve në fushën e Teknologjisë Informative
- Menaxhimi i fondeve publike nga Radio Televizioni i Kosovës
- Procedura me negociim pa publikim të njoftimit për kontratë
- Auditimi i granteve komunale në bazë të performancës
- Korniza Afatmesme e Shpenzimeve, dhe
- Auditimi përcjellës lidhur me zbatimin e rekomandimeve: Fondi Zhvillimor

Shtojca 2: Pasqyrat financiare dhe raporti i pavarur i auditorit

Pasqyrat financiare dhe raporti i pavarur i auditorit

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT

Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2018

Përmbajtja	Faqe
Raporti i Auditorit të Pavarur	
Neni 11. Deklarata për prezentimin e pasqyrave financiare	1
Neni 13. Pasqyra e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme	2
Neni 14. Raporti i ekzekutimi të buxhetit	3
Neni 15. Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare	4 - 17
Aneksi 1 Neni 14.6 Shpalosja e ndarjeve fillestare dhe finale të buxhetit	18
Aneksi 2 Neni 25. Raport për numrin e punëtorëve sipas listës së pagave	19
Aneksi 2 Neni 26. Raport për numrin e të punësuarve jashtë listës së pagave	19
Aneksi 2 Neni 27. Raport për numrin e të punësuarve me kontrate për shërbime të veçanta	20
Aneksi 2 Neni 28. Raporti për veprimet e ndërmarra dhe të propozuara për gjetjet dhe rekomandimet për Zyren Kombëtare të Auditimit për vitin paraprak	20

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

Për Auditorin e Përgjithshëm

Opinionin ynë

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Zyrës Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: "Organizata" ose "ZKA"), të cilat përfshijnë Pasqyrën e Pranimeve dhe Pagesave në Para të Gatshme dhe Raportin e Ekzekutimit të Buxhetit për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2018 dhe shënimet në pasqyrat financiare, duke përfshirë një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, performancën financiare të Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2018, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik - Raportimi Financiar në bazë të Bazës së Parasë së Gatshme të Kontabilitetit.

Bazat për Opinion

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve dhe kërkesave janë përshkruar më tej në seksionin e raportit tonë për përgjegjësitë e auditorit për auditimin e të pasqyrave financiare. Ne jemi të pavarur për organizatën në përputhje me Bordin e Standardeve Ndërkombëtare të Etikës të Kontabilistëve' Kodin e Etikës për Kontabilistët Profesionistë (kodi IESBA) së bashku me kërkesat etike të / L-014 Ligjit Nr 4 (për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim), të cilat janë relevante për auditimin e pasqyrave financiare në Kosovë, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe Kodin IESBA. Ne besojmë se evidenca e auditimit që ne kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë bazat për opinionin tonë.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pasqyrat Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar dhe për kontrollin e brendshëm i cili, në masën që përcaktohet nga Menaxhmenti, është i nevojshëm për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare pa pasaktësi materiale si rezultat i mashtrimeve apo gabimeve.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, Menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së organizatës për të vazhduar në vijimësi, shpalosjen, sipas rastit, çështjet që lidhen me vazhdimin në vijimësi dhe duke përdorur bazën kontabilitetit për vazhdimin në vijimësi, përveq nëse Menaxhmenti ose synon të likuidojë organizatën ose të pushojë operacionet, ose nuk ka asnjë alternativë realiste, përpos për ta bërë këtë. Të ngarkuarit me qeverisje janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Organizatës.

Përgjegjësia e Auditorit për auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi janë pa gabime materiale, qoftë nga mashtrimi apo gabimi, dhe të lëshojmë raportin e auditorit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një nivel të lartë të sigurisë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA gjithmonë do të zbulojë një pasaktësi materiale kur ajo ekziston. Pasaktësitë mund të lindin nga mashtrimi apo gabimi dhe konsiderohen si materiale nëse, individualisht ose së bashku, ato mund të pritet që të ndikojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra mbi bazën e këtyre pasqyrave financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticizmin profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e pasaktësive materiale në pasqyrat financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit, projektojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje ndaj këtyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë bazën për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një pasaktësie materiale që rezulton nga mashtrimi është më i lartë se për një pasaktësi që rrjedh nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshjen e fshehtë, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keqinterpretime apo shkelje e kontrolleve të brendshme.
- Marrim një kuptim të kontrolleve të brendshme relevante për auditimin me qëllim hartimit të procedurave të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat, por jo për qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të organizatës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe dhënien e informacioneve shpjeguese të lidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Konkludojmë mbi përshtatshmërinë e përdorimit nga Menaxhmenti të bazës së kontabilitetit për të vazhduar në vijimësi dhe në bazë të dëshmive të marra të auditimit, dhe nëse një pasiguri materiale ekziston në lidhje me ngjarjet ose kushtet që mund të hedhin dyshime domethënëse mbi aftësinë e organizatës për të vazhduar në vijimësi. Nëse arrijmë në përfundimin se një pasiguri materiale ekziston, ne jemi të detyruar për të tërhequr vëmendjen në raportin e auditorit tonë ndaj shpalosjeve të lidhura në pasqyrat financiare ose, nëse shpalosjet e tilla janë të pamjaftueshme, për të modifikuar opinionin tonë. Konkluzionet tona të auditimit bazohen në prova të auditimit të marra të deri në datën e Raportit të Auditorit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë që organizata të ndërpres së qeni sipas bazës së vazhdimit në vijimësi.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë dhënien e informacioneve shpjeguese, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet themelore dhe ngjarjet në një mënyrë që arrijnë një paraqitje të drejtë.

Ne komunikojmë me të ngarkuarit me qeverisje në lidhje me, mes çështjeve të tjera, shtrirjen e planifikuar dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, duke përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në kontrollet e brendshëm që ne identifikojmë gjatë auditimit tonë.

Ne gjithashtu sigurojmë të ngarkuarit me qeverisje me një deklaratë që jemi në pajtueshmëri me kërkesat përkatëse etike në lidhje me pavarësinë, dhe për të komunikuar me ta të gjitha marrëdhëniet dhe çështje të tjera që me arsye mund të mendohet të bien në pavarësinë tonë, dhe kur është e zbatueshme, masa mbrojtëse të lidhura.

Nga çështjet e komunikuar me të ngarkuarit me qeverisje, kemi përcaktuar ato çështje që janë të një rëndësie më të madhe në auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale. Ne përshkruajmë këto çështje në raportin e auditorit përveç kur ligji apo rregullorja e pengon zbulimin publik në lidhje me këtë çështje, ose kur, në rrethana shumë të rralla, përcaktojmë që një çështje nuk duhet të komunikohet në raportin tonë, sepse pasojat negative e të bërit këtë në mënyrë të arsyeshme mund të pritet të peshoj më shumë përfitimet e interesit publik nga komunikimi i tillë.

Raport tjetër mbi kërkesat rregullatore të autoritetit mbikqyrës, Kuvendi të Republikës së Kosovës për përputhshmërinë ligjore të ZKA.

Në bazë të kërkesave të Kuvendit të Republikës së Kosovës, ne kemi rishikuar aspektin e përputhshmërisë ligjore të ZKA-së. Nga rishikimi i kryer nuk kemi identifikuar ndonjë mospërputhje me ligjet që rregullojnë funksionimin e ZKA.


NDERMARRJA SHËRBËYESE
AUDIT GROUP
SH.P.K.
PRISHTINË

Rr: Str Ali Vitia, Blloku Administrata
10000, Prishtinë, Kosovë

12 Prill 2019

Neni 11

DEKLARATË PËR PREZANTIMIN E PASQYRAVE FINANCIARE

Për: z. Ahmet Ismaili, Drejtor i Përgjithshëm i Thesarit

Nga: z. Imri Semetishti, Zyrtar Kryesor Administrativ

z. Adem Sylejmani, Zyrtar Kryesor Financiar

Sipas mendimit tonë, pasqyrat financiare të cilat janë të bashkangjitura, përfshirë shënimet për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2018 janë përgatitur sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik "Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të bazuar në para të gatshme", i përmbushin të gjitha obligimet raportuese që dalin nga Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116, Ligjin nr. 04/L-194, Ligjin nr. 05/L-063 dhe Ligjin nr. 05/L-007 dhe janë të bazuara në shënimet financiare të mbajtura në mënyrë të duhur.

Kjo deklaratë jepet në lidhje me prezantimin e pasqyrave financiare të Buxhetit të Përgjithshëm të Kosovës të organizatës buxhetore për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2018.

Në konfirmojmë, për sa kemi njohuri dhe besim, që:

- Nuk ka pasur parregullsi lidhur me udhëheqësin apo me punëtorët, e cila ka mundur të ketë efekt material në pasqyrat financiare.
- Informatat e dhëna dhe të prezantuara në pasqyrat financiare lidhur me identifikimin e fondeve dhe shpenzimin e tyre të lidhura me Buxhetin e Kosovës janë të plota dhe të sakta.
- Informatat në lidhje me grumbullimin e të hyrave janë të sakta.
- Nuk ka llogari bankare të Buxhetit të Republikës së Kosovës përveç llogarive bankare të specifikuara në pasqyrat financiare dhe ky specifikim është i plotë dhe i saktë si në datën 31 dhjetor 2018.
- Nuk ka pasur shkelje të kërkesave të autoriteteve rregullative të cilat kanë mundur të kenë efekt material në pasqyrat financiare, në rast se do të shkeleshin.
- Nuk ka ndonjë ankesë (ligjore) në proces e cila mund të ketë efekt material në pasqyrat financiare.
- Të gjitha detyrimet, si ato aktuale ashtu edhe kontingjente, dhe të gjitha garancitë që u kemi dhënë palëve të treta janë regjistruar dhe/ose shpalosur në mënyrën e duhur.
- Të gjitha huatë për palët e jashtme janë regjistruar dhe/ose janë shpalosur, sipas rrethanave.
- Nuk ka pasur asnjë transaksion pas përfundimit të periudhës i cili do të kërkonte korrigjim ose shpalosje në pasqyrat financiare apo në shënimet e tyre.

Sipas mendimit tonë, pasqyrat financiare të konsoliduara që janë të bashkangjitura paraqesin një prezantim të vërtetë dhe të paanshëm të financave dhe transaksioneve financiare për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2018 të Zyrës Kombëtare të Auditimit.

Nënshkrimi dhe vula:

Imri Semetishti
Zyrtar Kryesor Administrativ

Data: 30.01.2019

Nënshkrimi dhe vula:

Adem Sylejmani
Zyrtar Kryesor Financiar

Data: 30.01.2019



Zyra Kombëtare e Auditimit

Neni 14. Raporti i ekzekutimi te buxhetit

Pasqyra e krahasimit të shumave buxhetore aktuale për Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin e përfunduar me 31 Dhjetor 2018

(Shumat ne mijë EUR, vetëm nëse përmendet ndryshe)

Shënime	2018				2017	2016
	Buxheti fillestar (Ndarja)	Buxheti final (SIMFK)	Realizimi	Varianca	Realizimi	Realizimi
	A	B	C	D=C-B	E	E
	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000
Hyrja e parasë së gatshme në llogari të Thesarit						
Grantet e përcaktuara të donatorëve	7	-	-	-	46	64
Te hyrat tjera	8	-	3	3	2	1
Pranimet totale të mbledhura për BKK-në			3	3	48	65
Daljet e parasë së gatshme nga llogaritë e Thesarit						
Pagat dhe mëditjet	2	2,020	2,003	2,003	1,757	1,690
Mallrat dhe shërbimet	3	651	816	631	(185)	507
Shërbimet komunale	4	45	36	30	(6)	25
Shpenzimet kapitale	5	75	54	51	(3)	13
Tjerat/Donacione	6	-	-	3	3	-
Totali i pagesave i bërë nga BKK nëpërmes LIVT		2,791	2,909	2,718	(191)	2,327

Zyra Kombëtare e Auditimit

Neni 13. Pasqyra e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme

Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2018

(Shumat ne mijë EUR, vetëm nëse përmendet ndryshe)

Shënime	2018		2017		2016
	Llogaria e vetme e Thesarit BKK	Pagesat nga palët e treta të jashtme	Llogaria e vetme e Thesarit BKK	Pagesat nga palët e treta të jashtme	Llogaria e vetme e Thesarit BKK
	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000
BURIMET E FONDEVE					
Granti qeveritar	2,696	-	2,273	-	2,194
Grantet e përcaktuara të donatorëve	7	19	54	-	41
Tjera/Donacion	8	3	-	-	-
Totali	2,718	-	2,327	-	2,235
SHFRYTEZIMI I FONDEVE					
Operacionet					
Pagat dhe mëditjet	2	2,003	1,757	-	1,690
Mallrat dhe shërbimet	3	631	530	-	507
Shërbimet komunale	4	30	28	-	25
		2,664	2,315	-	2,222
Shpenzimet kapitale	5	51	12	-	13
Tjera/Donacion	6	3	-	-	-
Totali		2,718	2,327	-	2,235

Zyra Kombëtare e Auditimit

Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare

31 Dhjetor 2018

(Shumat në mijë EUR, vetëm nëse permendet ndryshe)

Neni 15 Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare (vazhdim)

Shënimi 1 Informata për organizatën buxhetore (aktivitetet, legjislacioni, etj) dhe politikat kontabël

1.1 Entiteti raportues

Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) është institucion i pavarur kushtetues me mandat për kryerjen e auditimit të jashtëm në të gjitha organizatat buxhetore dhe në subjektet tjera shtetërore.

Misioni i ZKA-së është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojë llogaridhënien në administratën publike, në përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

ZKA kryen auditime për të siguruar se qeveria dhe entitetet e sektorit publik janë përgjegjëse për përdorimin dhe administrimin e fondeve publike:

- forcon përgjegjshmërinë, transparencën dhe integritetin duke audituar në mënyrë të pavarur aktivitetet e organizatave të sektorit publik dhe duke raportuar gjetjet e tyre;
- mundëson zyrtarëve të ngarkuar me qeverisjen e sektorit publik, të përmbushin përgjegjësitë e tyre duke iu përgjigjur gjetjeve të auditimit, rekomandimeve dhe duke marrë masa korigjuese të përshtatshme; dhe
- raporton mbi rezultatet e auditimit, duke i dhënë në këtë mënyrë mundësinë publikut të shikoj dhe të monitoroj përgjegjshmërinë e qeverisë dhe të entiteteve të sektorit publik.

1.2 Data e autorizimit

Pasqyrat Vjetore Financiare për vitin 2018, janë autorizuar nga ana e z. Imri Semetishtit, Drejtor i Përgjithshëm Administrativ dhe z. Adem Sylejmani, Zyrtar Kryesor Financiar me 31 Janar 2019.

1.3 Bazat e përgatitjes

Sipas ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësisë Nr. 03/L-048, të plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116, Ligjin nr. 04/L-194, Ligjin nr. 05/L-063 dhe Ligjin nr. 05/L-007, Zyrës Kombëtare të Auditimit i kërkohet të përgatitë dhe dorëzojë Pasqyra Financiare në përputhshmëri me kërkesat financiare dhe raportuese të Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik ("SNKSP") në përputhje me bazën e kontabilitetit me para të gatshme.

"Për më shumë, këto pasqyra financiare përfshijnë shpalosjet të kërkuara nëpërmjet Rregullores Financiare Nr. 01/2017 Për Raportimin Vjetor Financiar të Organizatave Buxhetore.

1.4 Politika kontabel

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me bazën e pranimin dhe pagesave në para të gatshme. Nën këtë bazë:

- a. Të hyrat njihen kur pranohen. Ato alokohen nga fondet e disponueshme në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës ("BKK"), të cilat janë për tu shpenzuar në lidhje me këtë ndarje dhe të njohur si "fonde të alokuara" për këtë ndarje.
- b. Shpenzimet njihen kur paguhen nga llogaria e BKK-së.
- c. Aktivet jo-monetare paraqiten për qëllime të shpalosjes. Kostoja historike për asetet e tilla përfaqëson kostot e blerjes dhe çdo shpenzim shtesë drejtpërdrejtë i atribuohet blerjes së aseteve.

Zyra Kombëtare e Auditimit
Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare
31 Dhjetor 2018

(Shumat në mijë EUR, vetëm nëse permendet ndryshe)

Neni 15 Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare (vazhdim)

1.5 Valuta raportuese

Librat dhe shënimet e ZKA-së mbahen në Euro, që është valuta ligjore në territorin e Republikës së Kosovës.

1.6 Prokurimi

Marrëveshjet kontraktuese për blerje të mallrave ose shërbimeve, duke përfshirë shërbimet profesionale, nënshkruhen në emër të ZKA-së, vetëm nga zyrtarët e autorizuar. Aktivitetet për blerje përveç nënshkrimit të kontratës, përfshijnë ftesën për tenderë, kuotime mbi bazën e specifikimeve të detajuara siç përcaktohet në Ligji mbi Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës

1.7 Zotimet

Zotimet, ashtu siç janë shpalosur në pasqyrat financiare, regjistrohen kur udhërohet ndonjë blerje që ka të bëjë me vitin aktual buxhetor.

1.8 Buxheti

Buxheti final është i përfshirë në Sistemin Informatikë të Menaxhimit Financiar të Kosovës dhe gjithashtu është publikuar si pjesë e pasqyrave financiare të konsoliduara të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Shënimi 2 Paga dhe rroga

		2018				2017	2016
		Buxheti final	GQ	Gjithsej pagesat	Krahasim %	GQ	GQ
Përshkrimi	Shënim	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000
Pagat neto përmes listës së pagave		1,668	1,668	1,668	100	1,466	1,413
Tatimi mbi të hyrat personale		5	5	5	100	120	113
Kontributi pensional nga punëdhënësi		140	140	140	100	84	80
Kontributi pensional nga i punësuari		95	95	95	100	84	80
Pagesa për Sindikatë		95	95	95	100	4	4
Paga dhe rroga		2,003	2,003	2,003	100	1,758	1,690

Zyra Kombëtare e Auditimit

Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare

31 Dhjetor 2018

(Shumat ne mijë EUR, vetëm nëse përmendet ndryshe)

Neni 15 Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare (vazhdim)

Shënimi 3 Mallrat dhe shërbimet

Përshkrimi	Shënim	2018					2017	2016
		Buxheti final	GQ	GPD	Gjithsej pagesat	Krahasim	GQ	GQ
		€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	%	€ '000	€ '000
Shpenzimet e udhëtimit brenda vendit		8	6	-	6	75	5	4
Meditja e udhëtimit brenda vendit	3.1	32	7	-	7	21	17	21
Akomodimi për udhëtimet brenda vendit	3.1	42	20	-	20	49	28	27
Shpenzimet tjera për udhëtimet brenda vendit		2	-	-	-	-	-	-
Shpenzimet e udhëtimit jashtë vendit	3.2	15	16	-	16	107	12	12
Meditja e udhëtimit jashtë vendit	3.2	47	41	-	41	89	37	20
Akomodimi për udhëtimet jashtë vendit	3.2	20	22	-	22	109	15	13
Shpenzimet tjera të udhëtimit jashtë vendit	3.2	3	5	-	5	175	3	-
Internet	3.3	2	7	-	7	287	2	2
Shpenzimet e telefonise mobile		27	27	-	27	101	27	16
Shpenzimet postare		2	2	-	2	81	1	-
Shërbimet e arsimit dhe trajnimit	3.4	20	3	-	3	17	11	9
Shërb e ndr.intelektuale këshilldhënëse	3.5	136	9	19	28	20	6	18
Shërb kontraktuale tjera	3.6	55	26	-	26	47	59	48
Shërbime teknike		2	1	-	1	60	1	1
Shpenzimet për anëtarësim		5	-	-	-	-	-	-
Mobiljet dhe pajisjet(më pak se 1000)	3.7	5	22	-	22	445	1	4
Telefona (më pak se 1000€)		2	1	-	1	44	2	2
Kompjuterë (më pak se 1000€)	3.8	23	22	-	22	94	30	46
Harduer për TI<1000		12	5	-	5	41	4	11
Pajisje trafiku		-	1	-	1	-	-	-
Pajisje tjera <1000€	3.9	11	24	-	24	219	8	2
Furnizime për zyrë	3.10	12	31	-	31	261	15	10

Zyra Kombëtare e Auditimit

Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare

31 Dhjetor 2018

(Shumat ne mijë EUR, vetëm nëse përmendet ndryshe)

Furnizime ushqim dhe pije	3.11	28	24	-	24	86	16	21
Furnizime pastrimi		1	-	-	-	-	-	-
Furnizime veshmbathje		1	-	-	-	23	-	-
Akomodimi	3.12	24	6	-	6	24	1	1
Vaj për ngrohje		15	6	-	6	39	7	12
Derivate për gjenerator	3.13	2	1	-	1	66	-	-
Karburant për vetura	3.14	11	11	-	11	99	8	4
Provizion bankar		-	-	-	-	-	-	-
Regjistrimi i automjeteve		1	1	-	1	92	1	1
Sigurimi i automjeteve		2	3	-	3	128	2	2
Taksa komunale		-	-	-	-	90	-	-
Sigurimi i ndërtesave dhe tjera		14	12	-	12	82	11	11
Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve	3.15	8	7	-	7	91	5	6
Mirëmbajtja e ndërtesave	3.16	26	27	-	27	104	15	16
Mirëmbajtja e tekn.informative		17	14	-	14	83	12	12
Mirëmb. e mobileve dhe pajisjeve		2	2	-	2	90	2	1
Qiraja për ndërtesa	3.17	146	147	-	147	100	141	126
Qiraja-pajisje	3.18	10	10	-	10	102	8	17
Qiraja perdorime tjera te hapsirave		4	1	-	1	24	1	2
Reklamat dhe konkurset	3.19	5	16	-	16	329	5	1
Informimi publik		1	-	-	-	12	-	-
Shërbime shtypje -jo marketing	3.20	8	9	-	9	107	6	6
Drekat zyrtare		7	3	-	3	49	5	2
Dreka zyrtare jashte vendit		-	-	-	-	-	-	-
Tatimi ne qira	3.21	-	14	-	14	-	-	-
Shpenzimet-vendimet e gjykatave		-	-	-	-	-	-	-
Kamata e borxhit		-	-	-	-	-	-	-
Mallra dhe shërbime		816	612	19	631	77	530	507

Zyra Kombëtare e Auditimit

Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare

31 Dhjetor 2018

(Shumat në mijë EUR, vetëm nëse përmendet ndryshe)

- 3.1 Si rezultat i rishikimit të vendimit nga Auditori i Përgjithshëm për uljen e medijtjeve si dhe ndarjes së një pjesë të projekteve audituese kompanive private të auditimit, shpenzimet për medijtjet brenda vendit janë më të ulta.
- 3.2 Bashkëpunimi në nivel ndërkombëtar është pjesë e portfolios tonë. Mjetet e shpenzuara ndërlidhen me pjesëmarrjen e punonjësve të ZKA-së nëpër punëtori dhe konferenca jashtë vendit. Shpenzimet për këtë kategori përfshijnë shpenzimet e anëtarësise në organizatat profesionale.
- 3.3 Shpenzimet më të larta janë si rezultat i fillimit të përdorimit të kontratës për shërbime telekomunikuese, në të cilën përfshihen edhe shërbime të internetit, të nënshkruara në mes të Qeverisë së Kosovës dhe PTK-s.
- 3.4 Shpenzimet për këtë kategori në veçanti përfshijnë shpenzimet e përkrahjes në aftësimin profesional të auditorëve. Gjatë këtij viti, shpenzimet janë më të ulta si rezultat i investimeve të mëhershme në përfundimin e financimit të skemës së auditimit.
- 3.5 Në këtë kategori përfshihen shpenzimet e realizuara ndaj kompanive të auditimit të angazhuara në kryerjen e auditimeve në emër të ZKA-së në disa Komuna, pagesat për anëtarët e jashtëm profesional, si dhe shpenzimet në angazhimin e këshilltarit të auditimit për projektin "Fuqizimi i kapaciteteve të Zyrës Kombëtare të Auditimit në projektet e auditimit të prokurimit" me Bankën Botërore
- 3.6 Shpenzimet e kësaj kategorie përfshijnë, pagesat për përkthyesit e përkohëshëm, kontraktuesit e tjerë, pagesat ndaj ATK-se, Trustin, si dhe pagesat e transportit publik "Trafiku Urban". Shpenzimet e kësaj kategorie janë më të ulëta, për shkak të përfundimit të projektit "Mbështetje të AP-së dhe ZKA-së në përmirësim të efikasitetit institucional" - të financuar nga Qeveria Zvicrane - Helvetas Swiss Intercooperation/DEMOS, në vitin 2017."
- 3.7 Në këtë kategori paraqiten shpenzimet për furnizim me mobilje për vitin 2018. Diferenca nga viti i kaluar është për shkak të ndërrimit të lokacionit të ZKA-së, dhe nevojës për mobilje të reja në objektin e ri.
- 3.8 Kjo shumë paraqet shpenzimet për furnizim me pajisje kompjuterike të TI-së për vitin 2018. Diferenca nga viti i kaluar është për shkak të kërkesave më të vogla gjatë vitit 2018.
- 3.9 Kjo shumë prezanton shpenzimet për furnizim me pajisje të TI-së për nevoja të ZKA-së. Shpenzimet janë rritur si rrjedhojë e furnizimit me sistem të qasjes në objektin e ri të ZKA-së, sistem të ri të komunikimit të brendshëm (projektorë, zërim, etj) dhe përgatitjes së sallës së trajnimeve.
- 3.10 Kjo shumë prezanton shpenzimet për furnizim me material zyrtar, furnizime të nevojshme të zyrës dhe gazeta ditore. Shpenzimet për këtë kategori janë rritur si rrjedhojë e ndryshimit të lokacionit të ZKA-së dhe nevojës për furnizime të domosdoshme për funksionimin e objektit të ri.
- 3.11 Kjo shumë prezanton shpenzimet të cilat ndërlidhen me organizimin e përvjetorit të pesëmbëdhjetë (15) të ZKA-së, shpenzimet e byfesë dhe shpenzimet për furnizim me ujë të pijes.
- 3.12 Kjo shumë prezanton shpenzimet të cilat janë realizuar për akomodimin e musafirëve me rastin e organizimit të përvjetorit të pesëmbëdhjetë (15) të ZKA-së.
- 3.13 Për shkak të ndërrimit të lokacionit, dhe nevojave për të vënë në funksion punën në institucion, si rrjedhojë e kohëpaskohëshme e ndaljes së rrymës janë rritur shpenzimet e kësaj kategorie.

Zyra Kombëtare e Auditimit

Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare

31 Dhjetor 2018

(Shumat në mijë EUR, vetëm nëse përmendet ndryshe)

- 3.14 Shpenzimet më të larta për karburant për këtë vit krahasuar me vitin 2017, janë si rrjedhojë e rritjes së numrit të auditimeve të kryera nga ZKA që ka ndikuar në rritje të kërkesave për transport.
- 3.15 Shpenzimet më të larta janë si rrjedhojë e furnizimit me goma për të gjitha veturat e ZKA-së. Në këtë shumë përfshihet edhe furnizimi me goma edhe për veturat e reja të blera gjatë vitit 2018.
- 3.16 Në muajin Gusht 2018, ZKA ka ndërruar lokacion dhe ka kaluar në objekt të ri. Shpenzimet më të larta janë si rezultat i punimeve në përshtatjen e hapësirave për punë për punonjësit e ZKA-së.
- 3.17 Në muajin Gusht 2018, ZKA ka ndërruar lokacion dhe ka kaluar në objekt të ri me hapësirë më të madhe dhe më të përshtatshme për punë. Shpenzimet më të larta janë si rrjedhojë e këtij ndryshimi, ku është siguruar një mjedis me kushte më të mira të punës për punonjësit e ZKA-së.
- 3.18 Në këtë kategori përfshihet marrja me qira e pajisjeve fotokopjuese për nevoja të ZKA-së, si dhe marrja me qira e pajisjeve të zëritit për organizimin e ngjarjeve dhe konferencave për nevoja të ZKA-së. Shpenzimet më të larta të kësaj kategorie janë si rezultat i organizimit të aktiviteteve të trajnimit, konferencave dhe seminareve.
- 3.19 Shpenzimet më të larta të kësaj kategori janë si rezultat i krentimit të pesëmbëdhjetë (15) vjetorit të ZKA-së, ku janë organizuar një mori aktivitete promovuese, ndër to është punuar edhe dokumentar historik për institucionin.
- 3.20 Shpenzimet e kësaj kategorie përfshijnë shtypjen & lidhjen e raporteve të punës së ZKA-së (RVP, RVA, Raportet e auditimit, broshura etj). Diferenca me vitin e kaluar është për shkak të rritjes së numrit të publikimeve gjatë vitit 2018.
- 3.21 Shpenzimet e kësaj kategorie për vitin 2018 janë të paraqitura në kodin përkatës, sipas planit kontabël.

Zyra Kombëtare e Auditimit

Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare

31 Dhjetor 2018

(Shumat në mijë EUR, vetëm nëse përmendet ndryshe)

Neni 15 Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare (vazhdim)

Shënimi 4 Shpenzimet komunale

Përshkrimi	Shënim	2018				Krahasim	2017	2016
		Buxheti final	GQ	GPD	Gjithsej pagesat		GQ	GQ
		€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	%	€ '000	€ '000
Rryma	4.1	24	18	-	18	76	18	17
Uji		3	2	-	2	89	2	2
Mbeturinat		2	2	-	2	88	1	1
PTK-fikse		7	8	-	8	107	7	5
Shpenzimet komunale		36	30	-	30	84	28	25

4.1 Në këtë kategori përfshihet shuma e shpenzimeve të rrymes për nevoja të ZKA-se. Shuma e shpenzuar është më e lartë si rezultat i ndërrimit të objektit, dhe kalimit në një objekt me hapësirë më të madhe.

Shënimi 5 Shpenzimet kapitale

Përshkrimi	Shënim	2018				Krahasim	2017	2016
		Buxheti final	GQ	GPD	Gjithsej pagesat		GQ	GQ
		€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	%	€ '000	€ '000
Blerja e centrales se re telefonike		-	-	-	-	-	-	13
Softuer dhe server per ruajtjen e te dhenave		-	-	-	-	-	12	-
Server per perforcim te infrastruktures se ZKA	5.1	22	19	-	19	87	-	-
Vetura zyrtare	5.2	32	32	-	32	100	-	-
Shpenzimet kapitale		54	51	-	51	95	12	13

5.1 Kjo shumë prezanton shpenzimin për furnizim me pajisje të teknologjisë informative, për përforcimin e infrastrukturës ekzistuese. Shuma e shpenzuar për këtë kategori është 18,793.29€.

5.2 Kjo shumë prezanton shpenzimin për furnizim me dy (2) vetura zyrtare për nevoja institucionale, në shumë prej 31,980 €.

Zyra Kombëtare e Auditimit
Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare
31 Dhjetor 2018

(Shumat në mijë EUR, vetëm nëse permendet ndryshe)

Neni 15 Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare (vazhdim)

Shënimi 6 Tjera/kthimi i donacionit

Shuma e mbetur prej 2,804.14€, është bartur nga viti 2017 nga përfundimi i projektit Helvetas Swiss Intercooperation - DEMOS, të cilat janë kthyer në llogarinë e donatorit.

Shënimi 7: Grantet e përcaktuara të donatorëve

Në vitin 2018, Qeveria e Kosovës ka alokuar mjete në shumë prej 164,615€ për zbatimin e projektit "Fuqizimi i kapaciteteve të Zyrës Kombëtare të Auditimit në auditim të prokurimit". Nga kjo shumë janë bërë shpenzime prej 18,862.75€, të cilat në SIMFK janë të raportuara si shpenzime nga Banka Botërore. Këto mjete do të rimbursohen në vitin 2019 nga Banka Botërore.

Emri i Donatorit	Nr. i projektit	Emri i projektit	2018	2017	2016
			€	€	€
			'000	'000	'000
Banka Botërore	94134	Zhvillimi i aftësive profesionale në auditimin e sistemeve të prokurimit	-	-	12
Bashkimi Evropian	94952	Projekti për mbështetje financiare të konferencës së tetë vjetore të ZKA	-	-	10
Qeveria Zvicrane	92003	Projekti "Në mbështetje të AP dhe ZKA për përmirësim të efikasitetit Institucional"	-	46	42
Banka Botërore	94138	Projekti për "Fuqizimin e kapaciteteve të Zyrës Kombëtare të Auditimit në auditim të prokurimit"	19	-	-
Gjithsej			19	46	64

Shënimi 8: Të hyrat tjera

Te hyrat tjera janë te hyrat e realizuara nga auditimi i rregullsisë i projektit "Përkrahje për përmirësimin e hartimit (zhvillimit) të politikave në Kosovë" sipas kontratës së datës 10.02.2017 dhe aneksit për angazhim shtesë të nënshkruar me 31.01.2018 ndërmjet SIDA-s dhe Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA) të Republikës së Kosovës në vlerë prej 2,590€, të derdhura në BK.

Zyra Kombëtare e Auditimit
Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare
31 Dhjetor 2018

(Shumat në mijë EUR, vetëm nëse përmendet ndryshe)

Shënimi 9 Neni 17 Raport për detyrimet (faturat) e papaguara

Kodi ekon.	Kategoria ekonomike	2018 € '000	2017 € '000	2016 € '000
11	Paga dhe rroga	-	-	-
13	Mallra dhe shërbime	14	14	11
14	Shpenzime komunale	2	3	3
20	Transfere dhe subvencione	-	-	-
30	Shpenzime kapitale	-	-	-
Totali		16	17	14

Detajet e faturave

Data e pranimit të faturës	Numri i faturës	Afati i pagesës	Kodi ekon.	Furnitori	Përshkrimi	Arsyeja e mospagesës	Shuma
1/9/2019	1848/2018	30 ditë	13610	Rhum Caffè	Gazeta ditore	Pranimi i fatures ne vitin 2019	56.00
1/10/2019	171227079783/1898	30 ditë	13310	Vala	Interneti/dhjetor	Pranimi i fatures ne vitin 2019	594.81
1/10/2019	161101068729/1896	30 ditë	13320	Vala	Telefonia mobile dhjetor	Pranimi i fatures ne vitin 2019	2,261.82
12/20/2018	12/.18	30 ditë	13953	SFK	Sigurimi fizik i objektit	fature e dhjetorit(sherbimi kryhet pas perfundimit te muajit)	901.00
	MFA2P801525501757	30 ditë	14510	ATK	Tatimi ne qira/dhjetor	Pagesa e muajit dhjetor duhet te paguhet deri ne dt 15 te muajit vijues	1,029.66
12/24/2018	F2018/022136	30 ditë	13330	DHL	Sherbime postare	Fatura e pranua pas skadimit te afatit ligjor per zotime	69.45
1/3/2019	01/2019	30 ditë	14020	Elcana	Mirembajtja e objektit/dhjetor	fature e dhjetorit(sherbimi kryhet pas perfundimit te muajit)	949.55
1/4/2019	AH0008	30 ditë	14130	Art House	Qiraja per fotokopje/dhjetor	Fatura e dhjetorit(sherbimi kryhet pas perfundimit te muajit)	302.63

Zyra Kombëtare e Auditimit
Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare
31 Dhjetor 2018

(Shumat në mijë EUR, vetëm nëse përmendet ndryshe)

12/4/2018	16/12/2018	30 ditë	13610	Arhing	Perde per Zyre	Fatura e pranua pas skadimit te afatit ligjor per zotime	390.00
		30 ditë	13640	ATK	Tatimi per keshilltarin James Bonell	Pagesa e muajit dhjetor duhet te paguhet deri ne dt 15 te muajit vijues	988.50
12/28/2018	Vendimi-29.01.2018	30 ditë	13410	Qendresa Sogojeva	Komp. per gj. angleze	Kerkesa pas skadimit te afatit ligjor per zotime	143.50
1/3/2019	dhjetor-specifikacion	30 ditë	13620	Euro Grill	Shpenzimet e byfese	fature e dhjetorit(sherbimi kryhet pas perfundimit te muajit)	149.00
12/28/2018	specifikacion	30 ditë	13130	Fetah Osmani	komp. per shpenz e rruges/naftes	Kerkesa pas skadimit te afatit ligjor per zotime	168.00
12/28/2018	Vendimi-29.01.2018	30 ditë	13410	Ilir Abazi	Komp. per gj. angleze	Kerkesa pas skadimit te afatit ligjor per zotime	92.75
1/17/2019	FDT18-8-005889	30 ditë	13720	Hib Petroll	Nafte per ngrohje qendrore	Fatura eshte pranue ne vitin 2019	4,479.53
1/17/2019	FDT18-8-005890	30 ditë	13780	Hib Petroll	Nafte per vetura	Fatura eshte pranue ne vitin 2019	810.40
1/18/2019	25	30 ditë	14010	Univerzal	Autolarje	Fatura eshte pranue ne vitin 2019	44.80
1/21/2019	005/19	30 ditë	13130	NSH.E-Victory	Sherbimet e taxit	Fatura eshte pranue ne vitin 2019	75.45
1/22/2019	Dec-18	30 ditë	13330	Posta e Kosovës	Sherbime postare	Fatura eshte pranue ne vitin 2019	121.20
Totali-Mallrat dhe sherbimet							13,628.05
1/3/2019	23757447	30 ditë	13210	KEDS	Rryma-dhjetor	Fature e dhjetorit(sherbimi kryhet pas perfundimit te muajit)	1,876.33
1/10/2019	550001841/1898	30 ditë	13250	Vala	Telefonia fikse-dhjetor	Fature e dhjetorit(sherbimi kryhet pas perfundimit te muajit)	486.56
1/14/2019	465444	30 ditë	13230	Pastrimi	Mbeturinat/dhjetor	Fature e dhjetorit(sherbimi kryhet pas perfundimit te muajit)	52.60
Totali-Sherbimet komunale							2,415.49

Zyra Kombëtare e Auditimit
Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare
31 Dhjetor 2018

(Shumat në mijë EUR, vetëm nëse permendet ndryshe)

Shenimi 10. Neni 18 Detyrimet kontingjente

Natyra e detyrimeve kontingjente	Arsyeja per detyrime	2018	2017	2016
		€ '000	€ '000	€ '000
Qiraja	18.1	11	10	10
Përbushje e kontratës	18.2	15	13	13
Totali		26	23	23

Shënim:

18.1 Shuma e prezantuar është një llogaritje e kompensimit eventual për riparime të ish-zyrës sonë, bazuar në kontestin gjyqësor, i cili është në proces.

18.2. Shuma e prezantuar paraqet vlerën e kontratës së nëshkruar për furnizim me material te zyres, e cila nuk është realizuar dhe e njëjta është në kontest gjyqësor.

Zyra Kombëtare e Auditimit
Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare
31 Dhjetor 2018

(Shumat në mijë EUR, vetëm nëse përmendet ndryshe)

Shënimi 11 Pasurite

11.3.1) Neni 19 Pasuritë kapitale (me vlerë mbi 1000€)

<u>Klasifikimi i pasurive</u>	<u>Shënim</u>	<u>Vlera neto - 2018</u>	<u>Vlera neto - 2017</u>	<u>Vlera neto - 2016</u>
		<u>€ '000</u>	<u>€ '000</u>	<u>€ '000</u>
Veturat	11.3.1.1	37	11	15
Pajisje të TI-së	11.3.1.2	32	9	0
Softuer	11.3.1.3	6	12	18
Pasuritë e tjera		1	2	3
Pasuritë fikse të paprekshme		9	10	9
Telefonia fikse		9	11	12
Totali		94	55	57

Shënim:

11.3.1.1. Gjatë vitit 2018 janë blerë dy vetura të reja zyrtare për nevoja të stafit të ZKA-së në vlerë prej 31,980€.

11.3.1.2. Gjatë vitit 2018 për nevoja të stafit të ZKA-së janë blerë pajisjet të Teknologjisë Informativë në vlerën prej 28,118 €.

11.3.1.3. Diferenca e vlerës neto në vitin 2018 krahasuar me vitin 2017 është si rezultat i vlerës së amortizimit gjatë 2018.

11.3.2) Pasuritë kapitale (me vlerë nën 1000€)

	<u>Shënim</u>	<u>Vlera neto 2018</u>	<u>Vlera neto 2017</u>	<u>Vlera neto 2016</u>
		<u>€ '000</u>	<u>€ '000</u>	<u>€ '000</u>
Pasuria nën 1000€		127	111	106
	11.3.2.1	127	111	106

Totali

Shënim:11.3.2.1

Blerjet e reja gjatë vitit 2018 arrijne vlerën 64,123 €.

Shuma prej 45,450€ prezanton vlerën e amortizimit të pasurive gjatë vitit 2018.

Zyra Kombëtare e Auditimit
Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare
31 Dhjetor 2018

(Shumat në mijë EUR, vetëm nëse permendet ndryshe)

11.3.3 Stoqet	Shënim	Vlera historike	Vlera historike	Vlera historike
		2018	2017	2016
		€ '000	€ '000	€ '000
Klasifikimi i pasurive				
Material shpenzues		14	14	17
Derivate për ngrohjen qendrore dhe gjenerator	11.3.3.1	2	6	7
Totali:		16	20	24

Shënim:11.3.3.1

Në kuadër të sasisë së përgjithëshme të naftës, sasia prej 1,330 litrave prezanton sasinë e naftës në rezervuarin e ngrohjes qendrore, ndërsa sasia prej 500 litrash prezanton sasinë e naftës në rezervuarin e gjeneratorit.

Zyra Kombëtare e Auditimit
Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare
31 Dhjetor 2018

(Shumat në mijë EUR, vetëm nëse permendet ndryshe)

Shënim 12 Neni 24 Raport për fondet e pashpenzuara të donatorëve

	Shënim	2018	2017	2016
		€ '000	€ '000	€ '000
Të hyrat e bartura nga donacionet	12.1	3	11	-
Të hyrat nga donacionet në këtë vit		-	45	66
Totali në dispozicion për ndarje në vitin aktual		3	56	66
Shuma e shpenzuar në vitin aktual	12.2	19	54	41
Shuma e fondeve të kthyer	12.3	3	-	12
Shuma e mbetur për bartje	12.4	(19)	2	13

Shënim:

Shënim 12.1

Ketu përfshihet shuma e mbetur prej 2,804.14 € e bartur nga viti 2017 nga përfundimi i projektit Helvetas Swiss Intercooperation – DEMOS.

Shënim 12.2

Në vitin 2018, nga shuma e alokuar prej 164,615€ nga Qeveria e Kosovës për zbatimin e projektit "Fuqizimi i kapaciteteve të Zyrës Kombëtare të Auditimit në auditim të prokurimit" janë bërë shpenzime në shumë prej 18,862.75€, të cilat në SIMFK janë të raportuara si shpenzime nga Banka Botërore. Këto mjete do të rimbursohen në vitin 2019 nga Banka Botërore.

Shënim 12.3

Ketu përfshihet shuma prej 2,804.14€ e kthyer tek Donatori për projektin e përfunduar me Helvetas Swiss Intercooperation - DEMOS.

Shënim 12.4

Shuma e prezantuar (18,862.75€), pasqyron shpenzimet të realizuara gjatë vitit 2018 nga mjetet e ndara nga Qeveria e Kosovës për zbatimin e projektit "Fuqizimi i kapaciteteve të Zyrës Kombëtare të Auditimit në auditim të prokurimit". Këto mjete do të rimbursohen nga Banka Botërore gjatë vitit 2019.

Zyra Kombëtare e Auditimit

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare

31 Dhjetor 2018

(Shumat në mijë EUR, vetëm nëse permendet ndryshe)

Aneksi I Neni 14.6 Shpalosja e ndarjeve fillestare dhe finale të buxhetit

Kategoria e ndarjes	Ndryshimet e autorizuara nga LMFP							Ndryshimet e buxhetit fillestar
	Shënim	Ndarja Fillestare Buxhetore (ligji i buxhetit)	Ndryshimi sipas nenit 29,Ligji nr.03/L-048	Ndryshimi sipas nenit 30,Ligji nr.03/L-048	Ndryshimi për te hyrat e tjera të financimit	Ndryshimet për grantet e përcaktuara te donatorëve	Ndarjet finale te buxhetit SIMFK	
		€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000
Hyrjet								
Grantet e percaktuara te donatoreve		-	-	-	-	-	-	-
Te hyra te tjera	14.6.1	-	-	-	-	-	-	-
Daljet								
Pagat dhe mëditjet	14.6.2	2,020	(17)	-	-	-	2,003	-1%
Mallrat dhe shërbimet	14.6.3	651		-	-	165	816	25%
Shërbimet publike	14.6.4	45	(9)	-	-	-	36	-20%
Shpenzimet kapitale	14.6.5	75	(21)	-	-	-	54	-29%
Totali		2,791	(47)	-	-	165	2,909	4.2%

Shënime:

14.6.1 shih shënimin shpjegues 7

14.6.2 Me Ligjin nr. 06/L-020, për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018, për kategorinë e Pagave dhe Meditjeve është aprovuar ndarja buxhetore në vlerë prej 2,019,594€. Ndërsa, Qeveria e Kosovës përmes vendimit me nr. 07/80 të datës 18.12.2018 për kursime dhe ndarje, dhe transfere buxhetore të organizatave buxhetore për vitin 2018, ZKA-së nga kategoria e pagave dhe meditjeve iu është reduktuar shuma prej 16,898€.

14.6.3. Me Ligjin nr. 06/L-020, për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018, për kategorinë e Mallrave dhe Shërbimeve është aprovuar ndarja buxhetore në vlerë prej 651,289€. Ndërsa, tek grantet e përcaktuara të donatorëve përfshihet shuma e alokuar prej 164,615€ nga Qeveria e Kosovës për zbatimin e projektit "Fuqizimi i kapaciteteve të Zyrës Kombëtare të Auditimit në auditim të prokurimit" e cila do të rimbursohet nga Banka Botërore sipas marrëveshjes.

14.6.4 Me Ligjin nr. 06/L-020, për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018, për kategorinë e Shërbimeve komunale është aprovuar ndarja buxhetore në vlerë prej 45,000€. Ndërsa, Qeveria e Kosovës përmes vendimit me nr. 07/80 të datës 18.12.2018 për kursime dhe ndarje, dhe transfere buxhetore të organizatave buxhetore për vitin 2018, ZKA-së nga kategoria e shërbimeve komunale iu është reduktuar shuma prej 9,085€.

14.6.5 Me Ligjin nr. 06/L-020, për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018, për kategorinë e Shpenzimeve kapitale është aprovuar ndarja buxhetore në vlerë prej 75,000€. Ndërsa, Qeveria e Kosovës përmes vendimit me nr.04/70 të datës 19.10.2018, në emër të kursimeve ZKA-së nga kategoria e shpenzimeve kapitale, iu është reduktuar shuma prej 21,382€.

Zyra Kombëtare e Auditimit
Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare
31 Dhjetor 2018
(Shumat në mijë EUR, vetëm nëse permendet ndryshe)

Aneksi 2 Neni 25. Raport për numrin e punëtorëve sipas listës së pagave

Departamenti	Nr i punëtorëve në Ligjin e buxhetit 06/L-020	Numri aktual i punëtorëve në fund të vitit 2018		Numri aktual i punëtorëve në fund të vitit 2017		Numri aktual i punëtorëve në fund të vitit 2016	
		Me orar të plotë	Me orar të shkurtuar	Me orar të plotë	Me orar të shkurtuar	Me orar të plotë	Me orar të shkurtuar
TOTALI	167	165	-	159	-	153	-
Staffi (Auditor & Mbështetës)	167	165	-	159	-	153	-

Shënim shpjegues:

**Numri i punonjësve në fillim të vitit 2018 ishte 159.

**Numri aktual i punonjësve në fund të vitit 2018 është 165."

Aneksi 2 Neni 26. Raport për numrin e të punësuarve jashtë listës së pagave

Departamenti	Numri aktual i punëtorëve në fund të vitit 2018		Numri aktual i punëtorëve në fund të vitit 2017		Numri aktual i punëtorëve në fund të vitit 2016	
	Me orar të plotë	Me orar të shkurtuar	Me orar të plotë	Me orar të shkurtuar	Me orar të plotë	Me orar të shkurtuar
Ekspert lokal dhe Ndërkombëtar	-	2	-	-	-	-
Totali	-	2	-	-	-	-

Shënim shpjeguese:

Gjatë vitit 2018, përmes përkrahjes së grantit nga Qeveria e Kosovës për zbatimin e projektit të ZKA-së me Bankën Botërore "Fuqizimi i kapaciteteve të Zyrës Kombëtare të Auditimit në auditim të prokurimit" ZKA ka angazhuar një ekspert lokal për ndihmë në procedurat e prokurimit si dhe një ekspert ndërkombëtar për të përmbushur misionin kryesor të projektit. Projekti vazhdon edhe në vitin 2019.

Zyra Kombëtare e Auditimit
Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare
31 Dhjetor 2018

(Shumat në mijë EUR, vetëm nëse permendet ndryshe)

Aneksi 2 Neni 27. Raport për numrin e të punësuarve me kontrate për shërbime të veçanta

Departamenti	Numri aktual i punëtorëve në fund të vitit 2018		Numri aktual i punëtorëve në fund të vitit 2017		Numri aktual i punëtorëve në fund të vitit 2016	
	Me orar të plotë	Me orar të shkurtuar	Me orar të plotë	Me orar të shkurtuar	Me orar të plotë	Me orar të shkurtuar
Stafi (Auditor & Mbështetës)	6	-	4	0	12	-
TOTALI	6	-	4	0	12	-

Shënim shpjegues:

Në vitin 2018, ZKA kishte gjithsejtë 6 punonjës me kontratë për shërbime të veçanta (Një (1) ekspert i sistemeve të TI-së), dhe (Pesë (5) Përkthyes të përkohshëm) të angazhuar gjatë periudhës së përgatitjes së raporteve të auditimit (Prill -Korrik 2018 dhe Shtator - Nëntor 2018)

Shtojca 3: Adresimi i rekomandimeve të auditimit për vitin 2017

Neni 28. Raporti për veprimet e ndërmarra dhe të propozuara për gjetjet dhe rekomandimet për Zyrën Kombëtare të Auditimit për vitin paraprak

Nr	Rekomandimi ose gjetja	Veprimi i ndërmarrë ose i propozuar	Afati i zbatimit	Efekti
1	Listat e pagave - Gjatë auditimit të BNj, është identifikuar se listat e pagave në raste të caktuara nuk janë nënshkruar nga punonjësit.	Janë ndërmarrë hapat që kjo çështje të gjej trajtim adekuat.	2018	Menaxhim adekuat i personelit
2	Gjatë kryerjes së procedurave të auditimit, është identifikuar se në dy nga artikujt e testuar, kontratat nuk janë vulosur dhe protokolluar nga kontraktori i autoritetit siç kërkohet me ligj. Nr. 04 / L042. Përveç kësaj, është identifikuar se nuk ka kontribut të deklaruar dhe të paguar të tatimit dhe pensioneve për mëditjet (duke iu referuar ligjit të ATK-së lidhur me Deklarimin e të Ardhurave Personale). Për më tepër, gjatë auditimit janë identifikuar dy raste në të cilat faturat për shpenzimet e bëra nga Organizata janë paguar më shumë se 30 ditë më vonë se data kur është pranuar fatura, siç kërkohet nga Menaxhimi i Ligjit të Financave Publike dhe Përgjegjësitë Nr. 03 / L-048 dhe me Rregullën Financiare Nr. 01/2013 ku thuhet se pagesa duhet të bëhet brenda 30 ditëve, vetëm nëse është specifikuar ndryshe në kontratë. Gjithashtu, gjatë auditimit tonë, kemi vërejtur katër raste kur faturat për shpenzimet e bëra nga Organizata nuk ishin regjistruar në librin e faturave ashtu siç kërkohet nga neni 24 i Rregullës Financiare Nr. 01/2013 / MF - Shpenzimet e Fondeve Publike.	Janë ndërmarr veprimet e nevojshme në adresimin e këtyre gjetjeve dhe kemi marr një mori veprishmesh në eliminimin e mangësive të shfaqura.	E finalizuar	Trajtim më i mirë administrativ
3	Gjatë kryerjes së procedurave të auditimit, është identifikuar një rast në të cilin kontrata nuk është vulosur nga Operatori Ekonomik. Përveç kësaj, është identifikuar një rast në të cilin shumica e kontratës së nënshkruar nuk ishte e njëjtë me shumën sipas Listës së Kontratave të Prokurimit të Nënshkruar.	Janë ndërmarr hapa konkret në përforcimin e kontrolleve të brendshme.	E finalizuar	Trajtim më i mirë
4	Bazuar në listën e pranuar të stoqeve, është identifikuar se karburanti nuk është paraqitur në listë. Bazuar në Raportin e Komisionit të Numrimit është identifikuar se - Nuk ka rregullore të brendshme të krijuara lidhur me kapitalizimin e pasurive siç kërkohet me rregulloren nr. 02/2013 të MF. - Të përfshira në listen e pasurive ende ekzistojnë disa pasuri jo financiare të cilat janë dhënë si donacion vite më parë. - Numërimi i inventarit në fund të vitit nuk u barazua me listen e inventarit. Përveç kësaj, të përfshira në listen e pasurive ka disa pasuri jo financiare që janë jashtë përdorimit.	Gjatë viti 2018, kemi ndërmarr hapa konkret në trajtimin e këtyre çështjeve, ku është miratuar/nxjerrë akti për trajtimin e pasurive jo-financiare, si dhe kemi marr një mori veprishmesh në eliminimin e mangësive të shfaqura.	E finalizuar	Trajtim më i mirë